




PLANI SOCIAL VENDOR 2026-2028 BASHKIA SARANDË



Planet lokale për shërbimet e kujdesit shoqëror janë një detyrim i bashkisë në përputhje me Ligjin (121/2016) “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen Vendore”

Ky dokument është hartuar nga Drejtoria e Kujdesit Social, Bashkia e Sarandë, nën kujdesin e znj. Anila Pikuli, dhe znj. Emanuela Çetri me kontributin e ZV/kryetarit të bashkisë Z. Florjan Sali, mbështetur nga grupi i punës i përbërë nga Znj. Teuta Maze, Znj. Garufo Koka, Znj. Irena Vjeri, Znj. Elvira Sadikaj, në konsultim me të gjithë aktorët lokalë dhe kujdesin personal të kryetarit të bashkisë z. Oltion Çaçi.

Tabela e Përmbajtjes

LISTA E SHKURTIMEVE.....	3
HYRJE.....	4
MISIONI, VIZIONI, PARIMET UDHËRRËFYESE DHE MONITORIMI.....	5
Misioni	5
Vizioni.....	5
Parimet udhërrëfyese	5
1.ANALIZA E SITUATËS SË GRUPEVE NË NEVOJË DHE SHËRBIMEVE EKZISTUESE.....	7
1.1 Vështrim i përgjithshëm.....	7
1.2 Individë në nevojë për shërbime dhe shërbimet egzistuese	8
1.2.1 Familje pa të ardhura/me të ardhura të pamjaftueshme	8
1.2.2 Persona me Aftësi të Kufizuara	13
1.2.3 Viktima të dhunës në familje	14
1.2.4 Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje	16
1.2.5 Familjet rome dhe egjiptiane	19
1.2.6 Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale.....	20
1.2.7 Struktura e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale	21
1.2.8 Shërbimet e kujdesit shoqëror në Qendrat Komunitare.....	22
<u>1.2.9 Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rasteve (NJVNR).....</u>	<u>26</u>
2.PLANI SOCIAL 2026-2028.....	27
2.1 Prioritetet e Zhvillimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.....	29
2.1.1 Zhvillimi i shërbimeve ekzistuese.....	29
2.1.2 Ngritja e shërbimeve të reja.....	30
2.2 Qëllimi i planit social 2026-2028.....	30
2.2.1 Qëllimi A dhe objektivat.....	30
2.2.2 Qëllimi B dhe objektivat.....	32
2.3 Strategjia e zbatimi i Planit social 2026-2028.....	33
3.PLANI I SHËRBIMEVE SOCIALE DHE AKTIVITETEVE	35

LISTA E SHKURTIMEVE

BS	Bashkia Sarandë
DKS	Drejtoria e Kujdesit Social
NJA	Njësi Administrative
NE	Ndihmë Ekonomike
NJVNR	Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit
MKR	Mekanizmi Koordinuar Referimit
ETN	Ekipe teknike ndersektorale
GTN	Grup teknik ndersektorial
S VK	Skuadra vendore e koordinimit
OJF	Organizata Jofitimprurëse
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuara
PMF	Punonjës Mbrotjes Fëmijëve
QZH	Qendra e Zhvillimit për femijet 4-16 vjeç
QZHFFF	Qendra e Zhvillimit të Femijeve dhe fuqizimit të familjes
QDP	Qendra Ditore Polivalente
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit Ministrave
ZVAKPA	Zyra Vendore e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

HYRJE

Sipas të dhënave të Censit të popullësisë dhe banesave në Shqipëri (2023) popullsia banuese në Bashkinë Sarandë është 22613 banorë nga të cilët 11393 janë meshkuj dhe 11220 femra. Ndërkohë që sipas regjistrit të gjendjes Civile në muajin korrik 2025 kemi 57452 banorë dhe 20731 familje.

Bashkia Sarandë është e organizuar me Njesinë qendrore Sarandë me një popullsi prej 19882 banorë dhe Njesinë administrative Ksamil 2731 banorë.

Sipas regjistrit të gjendjes civile kemi 48325 banorë në Sarandë dhe 9127 në Ksamil.

Nr i familjeve është 17653 në Sarandë dhe 3078 familje në Ksamil.

Shërbimet shoqërore përfshijnë një sistem të organizuar përfitimesh dhe lehtësirash, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të shërbimeve publike ose jo publike, për të garantuar mirëqenien, pavarësinë dhe përfshirjen sociale të individëve dhe familjeve që kanë nevojë për përkujdes shoqërore. Në Bashkinë Sarandë ofrojmë disa shërbime dhe gjatë vitit 2024 mesatarisht 158 persona kanë qenë përfitues të përkujdesit shoqëror, nga të cilët 22 fëmijë të akomoduar në qendrën rezidenciale për fëmijë “ Vangjel Pulla”, 37 fëmijë dhe 25 prinder kanë marrë shërbim në QMZHFFF, 35 fëmijë kanë marrë shërbim pranë Qendrës së Zhvillimit, 50 të moshuar janë trajtuar pranë QDP “ Feti Rugji” dhe 48 të moshuar kanë marrë shërbim në familje. Plani social përcakton qëllime dhe prioritetet tre vjeçare 2026-2028, të cilat synojnë të përmirësojnë mirëqenien dhe përfshirjen sociale të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror në Bashkinë Sarandë. Plani Social Vendor synon të konsolidojë shërbimet eksistuese dhe të krijojë shërbime të reja për qytetarët në përputhje me ndryshimet demografike, sociale dhe ekonomike të ndodhura. Drejtoria e Kujdesit Social ka ndjekur zbatimin e planit Social 2023- 2025 duke analizuar arritjet, dështimet dhe nevojat në përputhje me zhvillimet demografike, sociale, ekonomike. Hartimi i Planit Social Vendor 2026-2028 vijoi nëpërmjet një procesi të udhëhequr nga Drejtoria e Kujdesit Social në bashkëpunim me drejtoritë e tjera përgjegjëse si Drejtoria e Financës, Drejtoria e Personelit dhe Burimeve Njerezore, Drejtoria e Arsimit dhe Menaxhimit Financiar. Me urdhër nr 191 datë 11.07.2025 DKS udhëhoqi procesin e hartimit të planit deri në përgatitjen e draftit për konsultim.

Të drejtat e shtresave në nevojë dhe grupeve të rrezikuara janë në thelb të Planit Social Vendor, i cili shërben si një mjet kyç për të siguruar që këta individë të kenë akses në kujdesin dhe mbështetjen që u nevojitet. Grupet e rrezikuara, si të moshuarit, fëmijët, individët me aftësi të kufizuara dhe familjet me të ardhura të ulëta, familjet e komunitetit romë dhe egjiptian shpesh hasin pengesa të ndryshme për të marrë shërbime thelbësore. Plani Social siguron që jo vetëm të mbrohen të drejtat e tyre, por të ndihmohen duke lehtësuar procedurat e përfitimit të shërbimeve dhe krijuar shërbime gjithëpërfshirëse. Duke u mbështetur në kuadrin ligjor dhe standardet e të drejtave të njeriut, plani promovon barazinë, parandalon diskriminimin dhe synon fuqizimin e këtyre grupeve, duke krijuar përfundimisht një komunitet më të drejtë dhe mbështetës për të gjithë. Plani social mundëson shpërndarjen e burimeve financiare dhe njerëzore në mënyrë efektive, përmirëson koordinimin midis institucioneve dhe organizatave, dhe ofron një strukturë për monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve sociale. Gjithashtu, rrit ndërgjegjësimin e komunitetit dhe inkurajon angazhimin qytetar. Plani Social ndihmon në krijimin e një kuadri për shërbime kujdesi sociale të barabarta, të aksesueshme dhe efektive që përmirësojnë cilësinë e jetës për ata që kanë më shumë nevojë, duke promovuar drejtësinë dhe duke reduktuar pabarazinë.

MISIONI, VIZIONI, PARIMET UDHËRRËFYESE DHE MONITORIMI

Misioni

Bashkia Sarandë do të zgjerojë dhe konsolidojë hartën e shërbimeve të kujdesit shoqëror për t'ju përgjigjur nevojave në ndryshim për këto shërbime të qytetarëve të saj, përmes rritjes së kapacitetit dhe cilësisë së shërbimeve egzistuese, zgjerimit dhe diversifikimit të shërbimeve sociale, ofrimit të tyre sa më pranë individëve, si dhe shërbimeve inovatore, duke alokuar burime njerëzore e financiare, thëlluar partneritetin efektiv me institucione e orfues shërbimesh publik e jo publik, profesionistët si dhe komunitetin e donatorëve.

Misioni i Bashkisë Sarandë në fushën e shërbimeve sociale është të zhvillojë dhe konsolidojë politika, strategji dhe programe të kujdesit social, me qëllim që të ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Përmes tyre të mund të sigurojë shërbime të kujdesit shoqëror cilësore, të diversifikuara dhe inovative, për të përmbushur nevojat e qytetarëve, duke zbutur varfërinë, mbështetur personat me aftësi të kufizuara dhe promovuar deinstitutionalizimin e shërbimeve, përmes partneriteteve efektive dhe respektimit të të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore.

Vizioni

Bashkia Sarandë synon të sigurojë një sistem të integruar shërbimesh sociale që garanton mbështetje për grupet vulnerabël të shoqërisë dhe promovon përfshirjen sociale. Vizioni i saj qëndron në krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës ku cdo qytetar, pavarësisht statusit social dhe ekonomik, të ketë akses në ndihmë dhe mundësi të barabarta.

Përmes programeve të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale synohet të rritet cilësia e jetës për kategoritë vulnerabël dhe ne nevojë. Ky sistem shërbimesh duhet të jetë i tillë që të garantojë mbrojtje, zhvillim, pavarësi, pjesëmarrje në jetën e komunitetit për çdo individ që i ka të nevojshme këto shërbime.

Parimet udhërrëfyese

Sistemi komunitar i shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Sarandë do të vijojë të zhvillohet e zgjerohet në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe parimet universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë në bazë të këtyre parimeve themelore:

Parimi i universalitetit

Shërbimet e kujdesit shoqëror ekzistuese dhe të reja do të funksionojnë në përputhje me sistemin kombëtar të rregullave dhe standarteve. Bashkia përmes strukturës përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror do të monitorojë në mënyrë periodike përmbushjen e standarteve kombëtare nga ofruesit e shërbimit të ngritur apo financiar pjesërisht apo plotësisht nga Fondi Social i Bashkisë.

Parimi i drejtësisë sociale dhe mbështetjes shoqërore

Bashkia Sarandë është e angazhuar që, për individët që përmbushin kushtet për të përfituar nga shërbimet e kujdesit shoqëror, të respektojë të drejtën e tyre për të marrë shërbimet në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe për aq kohë sa janë në kushtet e të drejtës për ti përfituar shërbimet.

Parimi i deinstitucionalizimit

Shërbimet e kujdesit shoqëror do të sigurohen dhe ofrohen me prioritet pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit. Shërbimi komunitar do të prevaloje mbi shërbimin rezidencial. Në rastet kur individi për shkaqe dhe rrethana specifike do të vendoset në shërbim rezidencial strukturat ëprgjegjëse do të punojnë për qëndrim sa më të shkurtër në shërbimin rezidencial dhe rikthimin e tij në komunitet.

Parimi i mosdiskriminimit

Bashkia është e angazhuar për të mos lejuar asnjë formë të diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfituesit

Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror do të bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, integritetit të individit, besimit fetar dhe formimin e gjithanshëm të tij. Individët janë përgjegjës për jetën e tyre, prandaj do të inkurajohen që të marrin vendime për jetën e tyre gjatë gjithë kohës që marrin shërbime të kujdesit shoqëror.

Parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Të dhënat personale të individit, që trajtohet me shërbime të kujdesit shoqëror, janë konfidenciale dhe do të mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Punonjësi social, si dhe çdo person tjetër i angazhuar në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror do të ruaj konfidencialitetin e të dhënave personale të individit, për të cilin ka marrë dëgjim si pasojë e funksionit apo detyrës që kryen.

Parimi i partneritetit

Funksionimi i sistemit të shërbimeve shoqërore në Bashkinë Sarandë do të bazohet në një bashkëpunim të ngushtë midis qeverisjes qendrore dhe vendore, si financues kryesorë të shërbimeve shoqërore. Gjithashtu Bashkia është e angazhuar të zhvillojë partneritetin aktual me organizatat që punojnë për mbështetjen e grupeve në nevojë dhe respektimin e të drejtave të tyre, si dhe ta zgjerojë këtë partneritet me çdo organizatë, donatorë, grup interesi apo biznese lokale qëllimet dhe objektivat e të cilave përputhen me ato të këtij Plani Social.

ANALIZA E SITUATËS SË GRUPEVE NË NEVOJË DHE SHËRBIMEVE EKZISTUESE

1.1 Vështrim i përgjithshëm

Sipas të dhënave nga raporti i Census 2023 rezulton se popullsia banuese prej 22613 banore në bashkinë Sarandë ka rritje krahasuar me censin e vitit 2011 kur në të dy bashkitë egzistuese të asaj kohe Sarandë dhe Ksamil rezultonte një popullsi prej 20227 banore . Në këtë numer nuk ishte i përfshirë fshati Çuke i cili ka qenë në administrim të komunës Aliko. Duhet theksuar se edhe pse fenomeni i emigracionit është shumë i ndjeshëm në bashkinë Sarandë, për shkak të lëvizjeve të popullsisë brenda vendit, numri i popullsisë banuese ka shënuar rritje në vitin 2023.

Popullsia banuese e bashkisë Sarandë, sipas gjinisë dhe grupmoshat kryesore:

Gjithsej Total	0-14 vjeç	15-64 vjeç	65+ vjeç
22613	3565	14445	4603

Burimi: Censi i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri, 2023

Gjithsej Meshkuj	0-14 vjeç	15-64 vjeç	65+ vjeç	Gjithsej Femra	0-14 vjeç	15-64 vjeç	65+ vjeç
11393	1811	7303	2279	11220	1754	7142	2324

Burimi: Censi i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri, 2023

Shpërndarja e popullsisë sipas grupmoshës në njësitë administrative tregon që ka një numër më të lartë të popullatës 65 vjeç e lartë krahasuar me grupmoshën 0-14 vjeç, gjë që konfirmon nevojën për shtim të kapacitetit të shërbimeve për këtë kategori. Rritja e numrit të të moshuarve tregon domosdoshmërinë për shtimin dhe diversifikimin e shërbimeve për të moshuarit.

Popullsia banuese e bashkisë Sarandë sipas Njësi Administrative dhe grupmoshave kryesore:

	Total	0-14 vjeç	15-64 vjeç	65+ vjeç
Bashkia Sarandë	22613	3565	14445	4603
Sarandë	19882	3130	12646	4106
Ksamil	2731	435	1799	497

Burimi: Censi i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri, 2023

Sipas të dhënave të Census 2023 numri i personave me aftësi të kufizuara në bashkinë Sarandë është 1418 individë nga të cilët 28 janë të grupmoshës 5-14 vjec, 501 inividë janë të grupmoshës 15-64 vjec dhe 889 janë mbi 65 vjec. Ndërkohë që sipas pagesave të kryera për personat PAK nga Drejtoria e Kujdesit Social për vitin 2024 kemi 653 përfitues si persona me aftësi të kufizuara me 183 ndihmës personal. Gjithashtu 834 persona kanë qenë me statusin e invalidit të punës. Sic edhe vihet re nga të dhënat, të moshuarit përbëjnë dhe numrin më të madhe të personave që kanë vështirësi.

Nga ana tjetër vëmë re se jo të gjithë personat me moshë të re që përfitojnë pagesa paaftësie kanë deklaruar që kanë probleme të aftësisë. Kjo lidhet me paragjykimet e popullsisë lidhur me paaftësinë, gjë që shumë herë bëhet pengesë për diagnostikimin e hershëm apo parandalimin e saj dhe si rrjedhojë edhe ndërhyrjen e hershme.

Popullsia banuese 5 vjeç e lart me aftësi të kufizuara për bashkinë sipas gjinisë dhe llojit të aftësisë së kufizuara

	Popullsia me aftësi të kufizuara	Numri total i vështirësive	Në shikim	Në dëgjim	Në ecje	Kujtesë	Kujdesin e përditshëm ndaj vetes	Në komunikim
Gjithsej	1418	2927	8 244	6 431	17 745	6 054	6 848	4 889
Meshkuj	637	1395	241	191	375	188	238	162
Femra	781	1532	293	193	546	178	189	133

Burimi: Censi i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri, 2023

1.2 Individë në nevojë për shërbime dhe shërbimet egzistuese

1.2.1 Familje pa të ardhura/me të ardhura të pamjaftueshme

Sipas statistikave për vitin 2024 janë trajtuar mesatarisht me NE 286 familje . Për vitin 2023 janë trajtuar 310 familje në total. Për vitin 2024 vihet re që ka një ulje të numrit të familjeve përfituese të NE dhe të fondit total të shpenzuar nga transfertat e kushtëzuar, ndërkohë nga të ardhurat e bashkisë kemi rritje të fondit të shpenzuar.

Viti	Familje përfituese total	Familje përfituese nga sistemi menaxhimit	nga i te	përfituese nga fondi i kushtëzuar 6%	përfituese nga fondi i buxhetit vendor.
------	--------------------------	---	----------	--------------------------------------	---

		NE		
2023	310	250	28	32
2024	286	230	23	33

Fondi i shpenzuar NE

000 leke

Viti	Fondi gjithsej total	Fondi per familje perfituese nga sistemi i menaxhimit te NE	Fondi per familje perfituese nga fondi i kushtezuar 6%	Fondi per familje perfituese nga fondi i buxhetit vendor.
2023	21055	18373	1004	1678
2024	20729	17763	968	1998

Kjo ka ardhur si pasojë e skualifikimeve në sistemin e menaxhimit të NE edhe për familje të cilat janë në nevojë, me probleme sociale, shëndetësore, por edhe me një nivel të ulët arsimor dhe shpesh herë sepse për shkak të rrethanave nuk kanë respektuar rregullat lidhur me paraqitjen tremujore deklarimin e ndryshimeve etj

Numri i familjeve përfituese sipas njësive administrative per vitin 2024

Viti 2024	Familje përfituese total	Familje perfituese nga sistemi i menaxhimit te NE	përfituese nga fondi i kushtezuar 6%	përfituese nga fondi i buxhetit vendor.
<i>gjithsej</i>	286	230	23	33
<i>Sarandë</i>	246	198	22	26
<i>Ksamil</i>	40	32	1	7

24 familje janë përfituese si kategori të veçanta(status jetimi, viktima të dhunës në mardhëniet familjare, fëmijë të lindur tre, katër njakë etj)

Përsa i përket shpërndarjes të personave përfitues të NE në fund të vitit 2024 kemi në total 108 përfitues mbi 60 vjeç, 141 përfitues 18--40 vjeç, 154 përfitues 41-60 vjeç dhe 241 përfitues 0-18 veç.

Sipas gjinisë për vitin 2024 kemi 291 përfitues meshkuj dhe 372 përfituese femra të NE nga të gjitha skemat.

Viti 2024	Persona përfituese total	Persona perfituese nga sistemi i menaxhimit te NE	Persona përfituese nga fondi i kushtezuar 6%	Persona përfituese nga fondi i buxhetit vendor.
<i>Sipas grup moshës</i>	663	572	23	68
<i>Mbi 60 vjeç</i>	127	91	17	19
<i>41-60 vjeç</i>	154	134	2	18
<i>18-40</i>	141	126	2	13
<i>0-18</i>	241	221	2	18

Familjet nga grupet vulnerabël janë në fokus të programeve të mbështetjes sociale përmes pagesave të NE dhe shërbimeve të tjera që ato përfitojnë nga qendrat komunitare. Programi i NE konsiderohet si një mbështetje e përkohshme dhe duhet të punohet shumë më tepër në drejtim të formimit profesional, integritit të tyre në tregun e punës , aftësimin dhe integritin shoqëror.

Në raport me numrin total të familjeve përfituese të NE, familjet me kryefamiljare gra zënë një peshë rreth 43%, rreth 10% familjet që kanë në përbërjen e tyre PAK dhe rreth 7% familjet nga komuniteti rom dhe egjiptian.

Përqindja e lartë e familjeve përfituese me kryefamiljare gra, vjen sepse për skemën 6% të bllokskemës së NE dhe skemës nga të ardhurat e bashkisë aprovohen kriteret që e favorizojnë këtë kategori.

- Pagesa cash për NE rezulton të jetë shumë e ulët krahasuar me nevojat bazike të familjes. Në tabelën më poshtë kemi një pasqyrë që ilustron këtë fakt

Përbërja e familjes	1 anëtarë	2 anëtarë	3 anëtarë	4 anëtarë	5 anetare	6 anëtarë	Mbi 6 anëtarë
Pagesa e NE-së (mesatare)	2,178 deri ne 3100	3703 deri ne 4700 leke	4400 deri ne 5100 Lek	6000 deri ne 6600 Lek	8200 leke	9800 leke	11000Leke
Familje perfituese (nr mesatar)	77	59	24	24	1	0	0
Pagesa e NE-së (mesatare) Për familjet me kryefamiljare gra ose familjet me 3 ose më shumë fëmijë		5900 deri ne 6200 leke	8200 deri ne 9000 leke	10800 deri ne 11000 leke	13000 deri ne 14000 leke	11000 deri ne 16000 leke	16000 deri ne 19000 leke
Familje përfituese		14	19	13	17	10	4

Në këtë tabelë nuk janë përfshirë kategoritë e veçanta të përfituesve si viktimat e dhunes, statusi i jetimit etj. Pagesat për keto kategori janë të ndryshme nga ato për familjet në nevojë.

Ndeshimet me VKM në zbatim të ligjit 59/2019 kanë krijuar mundësinë që familjet me kryefamiljare gra, familjet me tre ose më shumë fëmijë, të trajtohen me dyfishin e pagesave krahasuar me pagesat e mëparshme. Kjo ka ndikuar në fuqizimin ekonomik të këtyre familjeve.

Sipas të dhënave të census 2023 në bashkinë e Sarandës kemi 1015 fëmijë që jetojnë me prind të vetëm, kemi 130 familje me baba të vetëm dhe 609 familje me nënë të vetme. Nënën e vetme zënë rreth 82% të prindërve të vetëm. Prindërit e vetëm janë një nga kategoritë që mund të kenë nevojë për shërbime mbështetëse për rritjen e fëmijëve me qëllim që prindërit të mund të

sigurojnë mirëqënien për fëmijën dhe familjen. Duke qenë se nënat e vetme kanë dhe numrin më të lartë të rasteve, rritet mundësia që shumë prej këtyre familjeve pa mundësi ekonomike dhe pa mbështetje nga familja e origjinës për rritjen dhe kujdesin e fëmijëve, të ndodhen në vështirësi dhe të kenë nevojë për mbështetje me pagesa cash dhe shërbime.

Nga ana tjetër kemi një rritje të numrit të divorceve dhe sipas Cens 2023 në bashkinë Sarandë kemi 536 persona të divorcuar dhe 1396 persona të ve. Të dyja këto kategori ndeshen me vështirësi si për përballimin e nevojave bazë të jetesës ashtu edhe për mirërritjen e fëmijëve. Familje me dy prindër me fëmijë kemi 3657 kurse çifte pa fëmijë 2662.

Popullsia banuese në Njësi Ekonomike Familjare sipas statusit familjar

Baba i vetëm	Nënë e vetme	Fëmija që jeton me prindin e vetëm
130	609	1015

Burimi: Censi i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri, 2023

Pra familjet edhe kur kanë një anëtar të punësuar vazhdojnë të kenë vështirësi në përballimin e kostos të jetesës, për shkak të problematikave të ndryshme sociale.

Pozitive është që ligji 59/2019 mundëson trajtimin me NE edhe të familjeve të cilat kanë anëtarë të punësuar.

Duke patur parasysh nivelin e ulët të pagesës, shpenzimet e ulëta të përgjithshme lidhur me përfitimet nga skema e Ndihmës Ekonomike, analizën e mësipërme lidhur me përbërjen e familjes, rezulton se numri i familjeve përfituese të NE-së që mund t'i shpëtojnë kthetrave të varfërisë është i ulët. Përmirësimi i shërbimeve komunitare dhe pasurimi i tyre është nevojë emergjente për të rritur cilësinë e jetës të familjeve dhe personave vulnerabël.

Situata e të papunëve në bashkinë Sarandë

Sipas të dhënave të ZVAKPA Sarandë kemi 1600 punëkërkues të papunë te regjistruar në këtë nga të cilët 1022 i përkasin bashkisë Sarandë. 28 prej tyre janë me statusin PAK.

143 persona kanë marrë formim profesional dhe 173 punëkërkues janë këshilluar dhe ndërmjetësuar për punësim. 45 persona, (30 femra dhe 15 meshkuj) nga këta kanë qenë përfitues të NE. Theksojmë se të gjithë përfituesit e NE, të aftë dhe në moshë pune referohen nëpërmjet skedave të punësimit në ZVAKPA .

Viti	Grupet Vulnerabël			
	NE	romë	Egjiptian	PAK
2022	240	3	0	3
2023	212	3	0	1
2024	180	11	0	0
2025	172	31	4	28

Siç shihet kemi një ulje të personave përfitues të NE që janë të regjistruar tek ZVAKPA.

Kjo ka ardhur sepse është ulur numri i familjeve përfituese në skemën e NE.

Nga ana tjetër kemi një rritje të numrit të personave PAK, romë dhe egjiptian., si rezultat i fushatave ndërgjegjësuere për integrimin të këtyre grupeve në tregun e punës si dhe

bashkëpunimin si në nivel ministrie ashtu edhe në nivel të institucioneve lokale për këtë proces të rëndësishëm. Theksojmë se periudha maj- shtator shënon një ulje si të punëkërkesve të papunë ashtu dhe të përfituesve të NE, si rezultat i punësimeve sezonale. Shifrat në tabelë pasqyrojnë të dhënat për gjendjen në fund të vitit përkatës. Për vitin 2025 të dhënat janë për muajin qershor.

Sipas ligjit 57/2019 kohëzgjatja e perfitimit të NE do të jetë për një periudhë 5 vjeçare me përjashtim të anëtarëve moshë pensioni dhe familjet që kanë anëtarë PAK në përbërje të tyre. Me zbatimin e këtij kriteri disa nga familjet përfituese të Ndihmës Ekonomike do të largohen nga skema që financohet nga buxheti i shtetit. Skema nga të ardhurat e bashkisë do të jetë mbështetëse në vazhdim.

Një pjesë e konsiderueshme e të papunëve të regjistruar për ndihmë ekonomike nuk kanë përfunduar arsimin fillor. Kjo sjell vështirësi në punësimin e qëndrueshëm të tyre, kurse për punësimin sezonal ky fakt nuk sjell ndonjë vështirësi. Ka nevojë që të përmirësohet përfshirja e romëve në vendet e punës në administratën publike, por niveli i arsimimit të tyre është një pengesë.

Pavarësisht përjekjeve, punësimi i personave me aftësi të kufizuara ka qenë dhe vazhdon të mbetet sfidë në Shqipëri. Ekziston akoma një qasje e punëdhënësve për të dhënë ose për të krijuar punë “më të lehta” për personat me aftësi të kufizuara, dhe jo një qasje që ka për bazë krijimin e një mjedisi të aksesueshëm dhe në përputhje me aftësitë e tyre dhe gjendjen fizike. Strategjia Kombëtare e Punësimin dhe Aftësive 2023-2030 parashikon integrimin në rritje të personave me aftësi të kufizuara në sistemet e zhvillimit të aftësive dhe të tregut të punës nëpërmjet ndërgjegjësimit më të lartë për angazhimin në jetën sociale; rritjes së kapaciteteve të strukturave të institucioneve për ofrimin e shërbimeve të përshtatura, përgatitjes së sektorit privat dhe punëdhënësve për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar dhe operacionalizimit të Fondit Social të Punësimin. Nga ana tjetër shpesh ndeshim në barriera të ngritura nga vet personat PAK, të cilët janë mosbesues ndaj ofertave të tregut të punës

Strehimi

Bashkia Sarandë me programet e saj të strehimit ndihmon grupet më të pafavorizuara, si familjet me ndihmë ekonomike, jetimët, gratë e divorcuara, emigrantët, komunitetin egjiptian dhe rom, policët e rënë në detyrë, çiftet e reja, PAK, etj, duke siguruar që ata të kenë akses në strehim të përballueshëm. Bashkia e Sarandës ka ofruar mbështetje për kategoritë në nevojë përmes programit të zbutjes së problemit të strehimit përmes zbatimit të “*Subvencionit të Qirasë*” për familjet e përcaktuara si kategori prioritare (sipas ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”) i ndryshuar si dhe familjet me të ardhura të pamjaftueshme për të përballuar qiranë e tregut të lirë. Subvencionimi i Qirasë ju vjen në ndihmë dhe mbështetje familjeve në nevojë për strehim të cilat jetojnë me qira në qytetin e Sarandës dhe kanë pamundësi ekonomike për të përballuar pagesën e qirasë së tregut të lirë.

Përgjatë 2024 janë mbështetur me Subvencionimin e qirasë 59 familje me probleme të ndryshme sociale si:

- Gra kryefamiljare me fëmijë në ngarkim 16 përfituese
- Familje që ka në ngarkim persona me aftësi të kufizuar dhe pension invaliditeti 13 përfitues
- Familje pjesë e komunitetit Rom-Egjiptian 2 përfitues
- Të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit 6 përfitues
- Viktima të dhunës në familje 1 përfitues

- Familje që trajtohen me ndihmë ekonomike 14 përfitues
- Familje me më shumë se 4 fëmije 1 përfitues.
- Familje njëprinderore 10 përfitues
Programi i permiresimit të banesave për shtresat e pafavorizuara 4 përfitues
- Familje që ka në ngarkim persona me aftësi të kufizuar dhe pension invaliditeti 1 përfitues
- Kryefamiljare gra 1 familje
- Të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit 3 përfitues
- Familje që trajtohen me ndihmë ekonomike 2 përfitues

Familjet e tjera janë familje në vështirësi ekonomike me të ardhura të ulta ose mesatare, të cilat përmes ofrimit të Subvencionit të Qirasë ju është dhënë mundësia për përballimin e qerasë së banesës, përmirësim dhe lehtësimin e kushteve të jetesës.

1.2.2 Persona me Aftësi të Kufizuara

Sipas statistikave të muajit dhjetor 2024, në Bashkinë e Sarandës janë 653 individë me aftësi të kufizuara (persona me aftësi të kufizuar, status verberi dhe status paraplegji) me 183 kujdestar dhe 834 persona me statusin e invalidit të punës që përfitojnë pagesa sociale, që përbën rreth 2.9 % të popullsisë totale sipas regjistrit të gjendjes civile. Kjo shifër përfshin vetëm ata që trajtohen me pagesë dhe nuk përfshin individët që nuk përfitojnë ndihmë monetare, por mund të kenë nevojë për shërbime dhe mbështetje. Nga këta, 834 janë invalidë pune, 460 kanë aftësi të kufizuara, 69 janë paraplegjikë dhe tetraplegjikë, dhe 124 janë individë me aftësi të kufizuara në shikim (status verberie). Po ashtu, janë të regjistruar 80 ndihmës personale për individët me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore, 69 për paraplegjikët, dhe 34 kujdestarë për ata me aftësi të kufizuara në shikim.

Në Bashkinë e Sarandës një numer i konsiderueshëm janë me aftësi të kufizuar mendore, të shëndetit mendor ose të përzier, gjë që nënkupton se këta persona kanë nevojë për shërbime të integruara. 41 persona janë me diagnozën e autizmit të cilët kanë nevojë për shërbime ditore përveç pagesës cash. Aktualisht në bashkinë tone kemi një shërbim për fëmijët PAK, por nuk sigurohet vazhdimësia e shërbimit pasi nuk ka një shërbim të tillë për personat mbi 16 vjeç.

Grupet me aftësi të kufizuara në Bashkinë e Sarandës përballen me sfida të shumta, përfshirë shpërndarjen e pabarabartë të shërbimeve dhe burimeve; nevoja për të adresuar problemet e shëndetit mendor; nevojë për përmirësimin e mekanizmave të identifikimit dhe raportimit të rasteve; pabarazia në shpërndarjen e fondeve është një tjetër sfidë, pasi njësitë urbane përfitojnë shumicën e fondeve, ndërsa zonat rurale kanë fonde minimale. Për të adresuar këto sfida, është e nevojshme të zhvillohen politika që rrisin mbështetjen dhe aksesin për zonat rurale dhe grupet më të prekura, si dhe të krijohet një mekanizëm monitorimi për shpërndarjen e drejtë të fondeve dhe shërbimeve.

Specific për Bashkinë Sarandë është se nuk ka Organizata jofitimprurëse që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Është vetëm një organizatë(Fondacioni Lidia) me kapacitet shumë të vogël. Organizatave u mungojnë burimet financiare të qëndrueshme, pasi shumica funksionojnë në bazë projektesh që varen nga prioritetet e donatorëve.

Përfitimi nga programet e nxitjes së punësimit për personat me aftësi të kufizuara mbetet minimal, për vitin 2024 kemi 2 përfitues nga keto programe

Subvencionimi i qirasë është një nga format kryesore dhe më e kërkuar e mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara. _Për vitin 2024, numri i përfituesve të subvencionit të qirasë ka qenë 13 përfitues. Shërbime të tjera që ofrohen për persona me aftësi të kufizuara në varësi të nevojave dhe grupmoshave janë: shërbimet psiko-sociale, terapi zhvillimi, fizioterapi. Shërbimet që ofrohen janë të kufizuara, aktualisht kemi qendrën e Zhvillimit për personat 4-16 vjeç ku trajtohen 35 fëmijë. Grupmoshat e tjera janë të pambuluara me shërbim. Nga ana tjetër ky shërbim nuk shtrihet në Njësinë administrative Ksamil dhe fshatrat përreth. Mungesa e shërbimeve për persona me aftësi të kufizuara theksohet edhe për faktin se referimet e komisionit bio-psikosocial mbeten të pa realizuara për shkak të mungesës së shërbimeve.

1.2.3 Viktima të dhunës në familje

Sipas të dhënave të Bashkisë Sarandë numri i rasteve të trajtuara për dhunë në familje ka qenë 26 raste për vitin 2022, 19 raste për vitin 2023 dhe deri në fund të vitit 2024 raportohen 23 raste. Pjesa më e madhe e viktimave të dhunës në familje të raportuara jetojnë në zonën urbane të Bashkisë. Diskutimet në grupet e zhvilluara me profesionistët e Njësisë të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit dhe administratorin shoqëror në Njësinë administrative Ksamil, nxorren në pah disa çështje të rëndësishme lidhur me dhunën në familje. Në zonat rurale, rastet e dhunës në familje janë më pak të raportuara në krahasim me zonat urbane për shkak të një kombinimi faktorësh kulturorë, socialë dhe logjistikë. Vlerat tradicionale dhe normat e forta sociale shpesh i japin përparësi privatësisë së familjes, duke çuar në një hezitim për të zbuluar çështje personale si dhuna në familje. Ekziston gjithashtu një stigmë e përhapur që rrethon viktimën, me frikën e gjykimit, turpit ose përjashtimit social nga komuniteti nëse abuzimi bëhet publik. Për më tepër, mungesa e ndërgjegjësimit dhe edukimit për mbrojtjen ligjore në dispozicion, së bashku me vështirësitë që kanë në transport, i dekurajon viktimat të kërkojnë ndihmë.

Rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare në Bashkinë Sarandë menaxhohen nga Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në bashkëpunim të ngushtë me Koordinatorin Vendore kundër Dhunës në Familje

Në zbatim të ligjit nr 125- 2020” “Për disa ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 për masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, , VKM-së nr. 327/2021“Për Mekanizmin e Bashkërendimit të Punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimit të viktimave të dhunës”, Bashkia Sarandë koordinon veprimtarinë e Mekanizmit të Referimit, në adresimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore duke siguruar mbrojtje, informim, ndihmë ekonomike, strehim emergjent dhe përfitime nga programet e strehimit social, ndërmjetësim për punësim, këshillim psikologjik dhe ligjor nëpërmjet Linjës Kombëtare të Këshillimit; këshillim për djem dhe burra përmes Linjës së Këshillimit për Djem dhe Burra; aktivitete ndërgjegjësuese dhe informuese të komunitetit; koordinim me të gjithë aktorët e mekanizmit në interes të viktimës.

Gratë e dhunuara janë një nga kategoritë që përfitojnë shërbimin e strehimit. Rastet që kanë përfituar shërbimin e strehimit kanë qenë: 5 raste për vitin 2022, 0 raste për vitin 2023 dhe 1 raste për vitin 2024.

Shërbimet kryesore të ofruara nga anëtarët e MKR-së për të mbijetuarit e dhunës në Bashkinë e Sarandës përfshijnë ndihmën juridike, këshillimin psikologjik, kujdesin shëndetësor, strehimin, ndihmën për punësim, mbështetjen për sigurimin e ushqimeve dhe produkteve të nevojshme, arsimimin dhe formimin profesional, bashkërendimin dhe referimin, dhe shërbime të tjera, si masat e sigurisë dhe vlerësimet e riskut. Në menaxhimin e rasteve të viktimave të dhunës bashkëpunohet edhe me OJF-të dhe sigurohet ofrimi i mbështetjes së posaçme për viktimat.

Viti	Urdhera Mbrojtje	VIKTIMA QE KANE MARRE SHERBIM			
		Ndihme Ekonomike	Programe Strehimi	Qendra e Emergjences	Sherbim psiko social
2019	42	16	2	2	35
2020	79	21	2	2	55
2021	50	27	3	6	45
2022	26	17	5	3	50
2023	19	15		1	35
2024	23	16	1		35

Persa i perket buxhetimit gjinor është vendosur në dispozicion për vitin 2021 një shumë prej 159.800 lekesh, në 2022 dhe 2023 300.000 leke dhe në vitin 2024 500.000 leke në vit që shkojnë për barazim gjinor, dhunë në familje dhe rastet sociale me problematika të ndryshme.

Qëndrueshmëria e koordinatorëve vendor të dhunës në familje ka kontribuar në konsolidimin e funksionimit të MKR-ve përsa i përket njëtrajtshmërisë së menaxhimit të rasteve, angazhimit të anëtarëve të ETN-së, ekspertizës profesionale, rrjetëzimit në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar dhe besueshmërisë së MKR-së.

Identifikimi i rasteve të dhunës në familje është një proces që kërkon angazhimin e aktorëve të ndryshëm të mekanizmit lokal përfshirë strukturat shëndetësore, të cilat nuk identifikojnë mjaftueshëm raste, ndonëse janë në kontakt të drejtpërdrejtë me komunitetin. NJVNR bëjnë një identifikim proaktiv të rasteve në nivel NJA me qëllim identifikimin e hershëm të rasteve. Në takimet që ato organizojnë në nivel komuniteti punohet edhe me qendrat shëndetësore për t'i informuar ata mbi sistemin e referimit të rasteve të dhunës. Në zonat rurale, raportimi i dhunës është i ulët për shkak të faktorëve të tillë si varësia ekonomike e viktimave nga dhunuesit, niveli i ulët i ndërgjegjësimit dhe mungesa e besimit në mbështetje nga mekanizmi lokal. Po ashtu, gratë me aftësi të kufizuara, si zonën urbane ashtu edhe në atë rurale, shpesh nuk raportojnë dhunën.

Menaxhimi i rasteve të dhunës në familje kërkon bashkëpunim të ngushtë midis koordinatorëve vendorë dhe punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve, të cilët janë të ngarkuar me menaxhimin e rasteve dhe ka një bashkëpunim shumë të mirë të profesionistëve. Shërbimet e emergjencave shpesh menaxhohen përmes ndihmave ushqimore dhe higjienike nga qendrat multifunktionale, ndërsa strehimi emergjent mundësohet edhe nga organizatat. Edhe pse Bashkia siguron bonusin e qirasë për viktimat, procedurat për ta përfituar këtë shërbim janë të ngadalshme. Sfidë tjetër mbeten menaxhimi i rasteve të viktimave me probleme të shëndetit mendor, përdoruesve të drogës dhe grave nga komuniteti rom, të cilat shpesh refuzojnë shërbimet edhe kur ato janë të disponueshme. Sfidë më e madhe ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve afatgjate dhe riintegruese për rastet.

Sistemi REVALB është përditësuar në kohë me rastet me UMM/UM.

Përgjatë vitit 2024 janë trajtuar me Ndihme Ekonomike si viktimë e dhunës në familje nga Drejtoria e Kujdesit Social 24 viktima dhune. Nga ku 24 janë trajtuar nga buxheti i shtetit në sistemin e menaxhimit të ndihmës ekonomike dhe 4 viktima janë trajtuar edhe nga të ardhurat e bashkisë 3 muaj mbas përfundimit të urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes. Theksojmë që viktimat e dhunës trajtohen me përparësi duke vendosur edhe kritere të posaçme me qëllim që kjo kategori të marrë shërbim. Shuma totale e trajtimit të tyre është 811800 lekë për 2024 nga të cilat 138600 lekë janë në Ksamil dhe pjesa tjetër në Sarandë. Nga të ardhurat e bashkisë për viktimat e dhunës shuma totale ka qenë 39600 lekë në vit.

Janë menaxhuar edhe rastet e viktimave të dhunës pa patur urdhër mbrotje nga gjykata duke u referuar në sistemin Revalb me qëllim parandalimin dhe përshkallëzimin e situatave të ndryshme që mund të ndodhin.

Për sa i përket takimeve të ndryshme të mekanizmit të rasteve të dhunës në familje janë realizuar 5 mbledhje ETN me problematika të ndryshme ku ka qënë i nevojshëm konsultimi me të gjithë aktorët pasi kanë qënë raste sensitive, ndërkohë që për rastet në përgjithësi të viktimave të dhunës është punuar individualisht dhe në bashkëpunim me aktorët e ETN pa qënë nevojë për tu mbledhur të gjithë aktorët.

Në kuadër të ndërgjegjesimit të komunitetit për fenomenin e dhunës në familje Bashkia Sarandë në bashkëpunim me shoqatën Jona, ka zhvilluar disa aktivitete sensibilizuese në kuadër të fushatës ndërkombëtare “16 Ditë të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore”. Këtu mund të përmendim aktivitete të ndryshme me të gjitha shkollat e qytetit, aktiviteti kulturor i organizuar pranë ambjenteve të bashkisë Sarandë.

Drejtoria e Kujdesit social duke përfshirë të gjithë specialistet e saj si : administrator shoqerore, koordinatori kunder dhunes ,punonjes social, punonjes per mbrojtjen e femijeve ,specialist I strehimit, qe te gjithë pa perjashtim jo vetem qe japin sherbim ne rastet e referuara nga aktoret e mekanizmit por veprojnë edhe në terren për verifikimin, indentifikimin dhe parandalimin e rasteve potenciale të dhunës me baze gjinore .

1.2.4 Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

Sipas të dhënave të Shërbimit Social Shtetëror Rajonal të Sarandës numri i fëmijëve pjesë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, për 2024 ka qënë 221 fëmijë.

Sipas punonjësës të mbrojtjes së fëmijëve dhe përfaqësuesve të OJF-ve, mekanizmi i koordinuar për mbrojtjen e fëmijëve e ka përmirësuar funksionimin e tij përgjatë viteve të fundit, dhe bashkëpunimi me anëtarët Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN) është zhvilluar rregullisht.

Rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje identifikohen kryesisht përmes punës së skuadrës së terrenit të bashkisë (e përbërë nga PMF-ja), si dhe përmes punonjësve të shërbimit psikosocial shkollor, me të cilët PMF-të raportojnë për një bashkëpunim shumë efikas në këtë drejtim. Policia gjithashtu identifikon dhe referon raste, por në këtë drejtim PMF-të raportojnë vonesa ose

vështirësi, si për shembull njoftimin e PMF-së pasi intervistimi i rastit ka ndodhur, për të firmosur formularin, ndërkohë që procedura parashikon pjesëmarrjen e tyre gjatë intervistimit. Ngritja e shërbimit të kujdestarisë është ende në fillim. Përsa i përket shërbimit të çerdheve dhe kopshteve, sipas të dhënave të strukturave arsimore, për sa i përket juridiksionit të bashkisë Sarandë ndodhen 1 çerdhe dhe 12 kopshte, të cilat me kapacitetet e tyre mbulojnë nevojat aktuale, në raport me numrin e fëmijëve që i frekuentojnë. Numri i fëmijëve në çerdhe e kopshte është 700.

Ndërkohë, lidhur me shërbimet shkollore për sa i përket bashkisë Sarandë nr i fëmijeve në shkollat 9-vjeçare është 2538 si dhe 614 fëmijë në gjimnaz, në shkollën profesionale ‘Antonio Athanas ‘ 131 femije. Numri i psikologëve dhe punonjësve socialë të punësuar në shërbimin psiko-social shkollor në total është 11 profesioniste, 30 mësues mbështetës nga të cilët 23 në shkolla dhe 7 në arsimin parashkollor. Rast suksesi është rekrutimi i 7 mësuesve mbështetës në arsimin parashkollor të cilët japin shërbim për 11 fëmijë.

Në vitin 2024 janë dhënë 22 bursa për rrezik braktisjeje dhe familjet në nevojë për arsimin 9-vjeçar si dhe 59 bursa për shkollat e mesme.

Për vitin 2025 janë dhënë 29 bursa për rrezik braktisjeje për arsimin 9- vjeçar si dhe 49 bursa për shkollat e mesme.

Menaxhimi i rasteve në nevojë për mbrojtje

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 janë menaxhuar 36 raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. 25 raste janë assistuar në komisariat. Asistimi në komisariatet e policisë është bërë nga PMF gjatë orarit zyrtar si dhe jashtë tij përfshirë edhe të shtunat dhe të dielat.

Grupet më vulnerabël brenda kësaj kategorie, sipas PMF-ve aktualisht janë fëmijët në situatë rruge, fëmijët që përjetojnë dhunë në familje. Lidhur me fëmijët në situatë rruge, (nga familje me probleme ekonomike dhe fëmijë të komunitetit Rom dhe Egjiptian) numri i tyre shtohet vazhdimisht në sezonin e verës, rrjedhimisht PMF-të gjatë kësaj periudhe intensifikojnë punën e skuadrës së terrenit, ndërkohë që kjo prodhon mbingarkesë dhe vështirësi, edhe në mungesë të mbështetjes me transport nga bashkia (qoftë përmes një mjeti, apo rimbursimit të shpenzimeve) dhe sjell që të ketë ende fëmijë në situatë rruge të paidentifikuar nga shërbimet e mbrojtjes. Në rastin e fëmijëve që përjetojnë dhunë në familje, menaxhimi i tyre bëhet në bashkëpunim me koordinatorin vendor për dhunën në familje.

Pavarësisht rasteve të fëmijëve në situatë rruge, në përgjithësi PMF-të e raportojnë mungesën e mbështetjes me transport si një sfidë për menaxhimin e rasteve që ndodhen në zona të largëta. Ka raste kur PMF-të nuk arrijnë të fillojnë në kohë vlerësimin e një rasti edhe në rrezik të lartë apo emergjent, për këtë arsye, nëse nuk lehtësohen nga OJF-të për transportin.

Lidhur me bashkëpunimin me aktorët e tjerë të sistemit, PMF-të raportojnë sfida në sigurimin e këshillimit për fëmijët në nevojë për mbrojtje, duke qenë se psikologët shkollorë mund të ofrojnë këshillim vetëm gjatë orëve të mësimin dhe nuk janë të disponueshëm në hapësira të tjera kohore; ndërsa lidhur me policinë, raportojnë situatë të paragjykitimit në raste të caktuara të viktimave/të mundshme të trafikimit, gjë e cila ndikon në reagimin e përshtatshëm ndaj nevojave të rastit, apo në ndjekjen dhe identifikimin e trafikantëve të mundshëm. Veç kësaj, në përgjithësi këto raste kanë nevojë për monitorim të vazhdueshëm nga policia, e cila raporton mbingarkesë në këtë drejtim dhe nuk i përgjigjet kësaj nevojë sic duhet. Sfidat e lartpërmendura lidhur me menaxhimin e rasteve kufizojnë ndjekjen intensive të tyre dhe punën për fuqizimin e familjes.

Për shembull, deri tani PMF-të raportojnë se nuk e kanë marrë asnjëherë masën për ndihmë të specializuar në mjedisin familjar.

Parandalimi

Ngritja e qendres rinore në vitin 2025 e cila ishte objektiv i Planit Social 2023-2025 do të kontribuojë veçanërisht në parandalimin e problematikave si delinkuenca rinore dhe abuzimi me substancat

Procesi i deinstitutionalizimit bazohet në VKM. 706 dt.09.09.2020 ku është miratuar “Plani Kombëtar i Deinstitutionalizimit 2020-2022” zbatimi i të cilit është shtyrë dhe Plani i Veprimit për zbatimin e tij, si edhe Urdhërit nr. 548 dt.01.10.2020 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Drejtues për zbatimin e planit Kombëtar të deinstitutionalizimit 2020-2022” dhe në piketat kryesore të hartuara për Planin e DEI 2025-2026 në kuadër të proceseve negociuese Kap 23.

Bashkia Sarandë është fokusuar në procesin e deinstitutionalizimit si një nga shtyllat kryesore të fokusit në sektorin e shërbimeve sociale duke rritur vëmendjen në fushën e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj fëmijëve. Pjesëmarrja aktive e përfaqësimit të Bashkisë Sarandë në Komitetin Drejtues, grupin teknik të punës dhe më pas në skuadrat vendore të koordinimit (SVK) kontribuon dhe do të vazhdojë të japë ndihmesën e saj në gjithë procesin në përmirësimin e infrastrukturës ligjore, ekspertizës teknike të ofruar prej çdo punonjësi të mbrojtjes së fëmijëve në kontakt me çdo fëmijë dhe familje në proces deinstitutionalizimi.

Procesi i deinstitutionalizimit të sistemit të kujdesit për fëmijët, bazohet në ndryshimin e tipologjisë së ofrimit të shërbimeve: nga institucione rezidenciale në shërbime ditore, si dhe shërbime të tjera alternative, me bazë komunitare, duke u përqëndruar në integrimin e fëmijëve në familje, qofshin ato biologjike apo kujdestare, në komunitete dhe shoqërinë e gjerë duke respektuar interesin më të lartë të fëmijës.

“Çdo fëmijë duhet të jetë në gjendje të gëzojë standard jetese të përshtatshëm për zhvillimin e tyre fizik, mendor dhe shoqëror, dhe duhet të rritet në një mjedis familjar miqësor” – bazuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës.

Konkretisht Bashkia Sarandë e ka hedhur një hap në këtë drejtim duke ngritur një shërbim të ri QMZHHFF. Një nga objektivat e saj është parandalimi i institutionalizimit të fëmijëve.

Aktualisht është ngritur një mekanizëm funksional për identifikimin e nevojave të fëmijës në tërësi, në IPSH, në familje dhe komunitet ku një rol të rëndësishëm ka pmf, NJVNR, DKS si dhe shërbimet shoqërore që ofrohen në territor. Të gjithë aktorët përfshihen për të qënë pjesë ndihmuese në përmirësimin e situatës sociale ekonomike të çdo familjeje të identifikuar. Hartohen planet individuale të zhvillimit për çdo fëmijë dhe plani i fuqizimit të familjes duke hedhur hapa konkrete për përmirësimin e gjendjes sociale ekonomike të familjeve dhe parandalimin e institutionalizimit të fëmijëve.

Ana tjetër e DEI është edhe largimi i fëmijëve nga institucionet rezidenciale për tu kthyer pranë familjes biologjike, familjeve kujdestare ose birësim. Është punuar kryesisht për kthimin e fëmijëve në familjen biologjike duke bashkëpunuar edhe me ISHP-në për fëmijët që janë me leje banimi në bashkinë Sarandë dhe me Shërbimet Sociale të bashkive të tjera për fëmijët që familjet e origjinës i kanë në bashki të tjera. Përsa i përket akomodimit të fëmijëve pranë familjeve kujdestare, edhe pse janë ndjekur disa hapa si psh ngritja e komisionit “Për Parandalimin e Institutionalizimit dhe ofrimin e Kujdesit Alternativ” nuk ka patur ndonjë rezultat pasi identifikimi i familjeve kujdestare ka rezultuar jashtëzakonisht i vështirë.

Qendra rezidenciale për fëmijët shkollor” Vangjel Pulla” është në process rikonstruksioni. Aktualisht marrin shërbim në këtë institucion 8 fëmijë(4 femra dhe 4 meshkuj) dhe shërbimi është transferuar pranë konviktit të shkollës së mesme. Për shkak të kapacitetit të kufizuar të godinës 10 fëmijë janë transferuar përkohësisht pranë qendrës” Shpresë për Botën”, 4 fëmijë pranë shtëpisë së fëmijës “Zyber Hallulli” kurse 2 fëmijë pranë Shtëpisë së fëmijës 16-18 vjeç Shkodër pasi kishin mbushur moshën për transferim. Një fëmijë është në process për shpallje i braktisur gjë që mundëson fillimin e procedurave për kujdestari alternative apo birësim. Për të gjithë fëmijët janë hartuar planet e fuqizimit dhe përditësohen vazhdimisht. Në tre vitet e fundit nuk kemi asnjë rast të akomodimit të fëmijëve të bashkisë sonë në institucion. Në parandalimin e institucionalizimit ka ndikuar edhe ngritja e shërbimit ditor për fëmijët nga shtresat në nevojë dhe me probleme Sociale, e cila punon në dy drejtime, si në zhvillimin e fëmijëve, ashtu edhe në fuqizimin e familjeve dhe prindërimin e mirë.

Procesi i DEI për këtë grupmoshë është shumë i vështirë, por si stafi i institucionit ashtu edhe stafi i sektorit të shërbimit social punojnë fort për finalizimin e tij.

Aktualisht një fëmijë është në process birësimi, një fëmijë është në proces kujdestarie me lidhje gjaku dhe një fëmijë në process kthimi në familjen biologjike.

Kthimi në familjen biologjike rezulton të ndodhë me një frekuencë shumë të ulët për shkak se fëmijët në institucion nuk vinë nga territorri i Bashkisë Sarandë, por nga Bashki të tjera, kështu që puna me familjen biologjike, fuqizimi i saj është një aktivitet që zhvillohet në bashkinë e origjinës.

Shërbimet e ofruara për fëmijët dhe familjet që ndodhen në nevojë përfshijnë mbështetjeje sociale dhe ekonomike. Këto shërbime përfshijnë vizita në familje dhe vlerësime psikologjike, sociale dhe ekonomike, si dhe mbështetje me paketa ushqimore dhe veshmbathje. Ndihma psiko-sociale, asistimi në përgatitjen e dokumentave për bonusin e qirasë. Për prindërit, përfshirja në klubet e prindërimit është një mundësi tjetër për t’u mbështetur dhe informuar. Këto shërbime synojnë të sigurojnë një mbështetje të plotë dhe të qëndrueshme për fëmijët dhe familjet, me qëllim që të sigurohet interesi më i lartë i fëmijëve.

1.2.5 Familjet rome dhe egjiptiane

Janë të paktën 35 familje rome të identifikuara në territorin e Bashkisë Sarandë. Nga këto 22 prej tyre trajtohen nga një prej skemave të NE. Përsa i përket familjeve egjiptiane ato nuk vetidentifikohen si të tilla, por si familje të komunitetit mazhoritar. Këto familje janë kryesisht të vendosura në fshatin Çukë , ku për hir të së vërtetës përgjithësisht jetojnë në kushte të papërshtatshme për jetesë. Strehimi i tyre është objekt dhe është i trajtuar gjerësisht në Planin e Strehimit 2024-2028.

Në vitin 2023, 19 familje Rome dhe Egjiptiane përfituan nga programet e strehimit social të me 16 familje në programin e subvencimit të qirasë dhe 3 në programin e përmirësimit të kushteve të banesave. Në vitin 2024 kemi 2 përfitues në programin e subvencimit të qirasë.

Problem në periudhën e verës janë familjet rome me fëmijë që vijnë në Sarandë nga qytete të tjera duke ushtruar lypjen.

Gjithashtu 60% e familjeve rome në teritorin e bashkisë përfitojnë ndihmë ekonomike

Skuadrat e terrenit kanë menaxhuar 14 raste të fëmijëve në situatë rruge, duke i referuar ata në bashkitë përkatëse. Përsa i përket familjeve me venbanim në Sarandë, këto familje janë fuqizuar e anë të NE, financim të qerasë në tregun e lirë etj. Qendra Komunitare ka organizuar takime për të informuar prindërit mbi rreziqet e martesave të hershme dhe trafikimin e qenieve njerëzore, parandalimin e braktisjes së shkollës etj.

1.2.6 Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale

Plakja e popullsisë është një fenomen global. Gjatë 30 viteve të fundit ndërmjet viteve 1990 dhe 2020, popullata shqiptare ka pësuar një përmirësim të ndjeshëm të jetëgjatësisë për të dy gjinitë, shoqëruar me një ulje të ndjeshme të normës totale të fertilitetit si dhe një nivel të konsiderueshëm të fluksit të migracionit. Si rezultat, popullsia e moshës 65 vjeç e lart është rritur me 2,3 herë nga 180 mijë në vitin 1990 në 420 mijë deri në vitin 2020. Prandaj, përqindja e popullsisë në moshën 65 vjeç e lart është rritur nga 5,5 për qind në vitin 1990 në 14,8 për qind nga 2020.

Moshimi i popullsisë pritet të sjellë një rritje të konsiderueshme në kërkesën për kujdes afatgjatë në 30 vitet e ardhshme. Vlerësohet se numri i personave potencialisht në nevojë për kujdes afatgjatë në Shqipëri do të rritet nga numri aktual i vlerësuar prej 90.9 mijë në 130.4 mijë (43 për qind rritje) në 2030, 160.9 mijë në 2040, dhe 161.1 mijë në vitin 2050. Rritja është veçanërisht e ndjeshme për gratë. Meqenëse përqindja e popullsisë së moshës 80 vjeç e lart parashikohet gjithashtu të rritet, kostoja e kujdesit të nevojshëm mund të rritet edhe më shpejt se numri i personave që kanë nevojë për kujdes.

Në Shqipëri, numri i personave të moshuar po rritet vazhdimisht, duke përbërë një sfidë të rëndësishme për shoqërinë dhe sistemin e shërbimeve sociale. Mbulimi i popullsisë me shërbime sociale ka pësuar rritje përgjatë viteve si nga pikëpamja e përfituesve dhe nga pikëpamja gjeografike. Nga 10,000 përfitues në vitin 2019 ose 0.35% e popullsisë në 42,553 përfitues në vitin 2022, ose 1.5% e popullsisë (objektivi i strategjisë së mbrojtjes sociale 2023 ishte një nivel mbulimi 0.5% të popullsisë për vitin 2022).

Qeveria shqiptare miratoi në vitin 2019 Planin Kombëtar të Veprimit mbi Moshimin 2020- 2024 dhe është në proces për hartimin e planit në vazhdim. Ky plan është dokumenti i parë i politikave që trajton shërbimet e kujdesit afatgjatë për të moshuarit. Plani Kombëtar i referohet nevojës për shërbime të integruara sociale dhe shëndetësore dhe nevojës për zgjerimin e shërbimeve komunitare dhe rritjen e kapaciteteve të ofruesve të kujdesit.

Kujdesi në banesë është një ndër aktivitetet themelore për t'iu garantuar njerëzve të moshuar në kushte të brishta (pjesërisht ose plotësisht jo autonomë) qëndrimin në banesën e tyre. Në aspektin e përmbajtjes bëhet fjalë për shërbime të karakterit përkuajdesës (mbështetje ndaj personit dhe mjedisit) të kryer nga personel i kualifikuar në shtëpitë e të moshuarve me qëllim kufizimin e rënies funksionale dhe rivendosjen (kur është e mundur) e aftësive të personit të moshuar, duke i kthyer atij autonominë në jetën e përditshme dhe duke favorizuar gjithashtu përfshirjen e tij në kontekstin social. Shërbimi në banesë për të moshuarit është mundësuar përmes Projektit “Leave No One Behind” ofruar nga organizata UNDP Albania në bashkëpunim me Bashkinë Sarandë duke synuar përmirësimin e cilësisë së jetës së 59 të moshuarve në 52 familje të shtrira në gjithë juridiksionin e bashkisë Sarandë, nëpërmjet shërbimit të kujdesit në banesë ofrohen shërbime

psiko-sociale, shërbim shëndetësor në banesë, sigurim dhe ofrim i pajisjeve dhe materialeve mjekësore në banesë si dhe paketa ushqimore ne banese . Projekti perfshinte vitin 2024, sfide per kete sherbim eshte vazhdimesia e tij nder vite .

Gjithashtu në qendrat komunitare të moshuarit marrin shërbime ditore dhe për vitin 2024 kanë përfituar 53 të moshuar. Lind nevoja për konsolidim të shërbimit dhe shtim të shërbimeve si shërbimi psikosocial dhe asistencë mjekësore periodike. Disa nga shërbimet që përfitojnë janë: aktivitete sociale; vakte ushqimore; socializimi me të moshuar të tjerë dhe më përfitues të kategorive të tjera të qendrave; kujdes shëndetësor, etj.

1.2.7 Struktura e shërbimeve shoqërore në Bashkinë Sarandë

Stafi në Zyrën e Shërbimeve dhe Mbështetjes Sociale është në numër të kufizuar, kjo situatë sjellë mbingarkesë. Numri i stafit të parashikuar me ligji dhe ai aktual kanë një diferencë të konsiderueshme prej 6 punonjësish. Bashkia Sarandë në fushën e kujdesit shoqëror përmbush zbatimin e ligjit me burime njerëzore në masën 60%. Indetifikohet nevoja e shtimit të stafit dhe plotësimi i vendeve vakant.

Tabela: Numri i punonjësve aktual dhe nevojat sipas ligjit në Drejtorinë e Kujdesit Social Sarandë dhe Ksamil

Nr	Emërtimi	Emërtimi në strukturën e Bashkisë	Nr aktual	Sipas ligjit	minimalisht	Paga
1	Drejtor	Drejtor	1	1	1	
2	Administrator shoqëror	Administrator shoqëror	4	4	4	
	Përgjegjës për strehimin	S'ka	0	1	1	
	Administrator shoqëror strehimi		1	1	1	
	Njësia e Vlerësimit të Rastit dhe nevojave		3	7	4	
	Përgjegjës	Përgjegjës i NJVNR	1	1	1	
	Punonjës social		0	1	1	
3	Njësia e mbrojtjes së fëmijëve	Specialist për mbrojtjen e fëmijëve	1	3	2	

	Koordinator kundër dhunës në mardhëniet familjare	Specialist kundër dhunës në familje	1	1	1	
4	Nëpunës për barazinë gjinore	Specialist për barazisë gjinore dhe dhunën në familje	0	1	0	
	Totali		9	14	11	

Situata: 8 punonjës në Bashkinë Sarandë dhe 1 punonjës në Njesinë administrative Ksamil
Nevojat:

1) Minimalisht 1 punonjës shtesë në Ksamil NJVRN dhe PMF

2) 2 punonjës shtesë në Sarandë, një punonjës i vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit - NJVNR dhe një pmf. Fokusi të vendoset në plotësimin e vendeve vakante dhe rishikim i strukturave ekzistuese.

Në zbatim të planit social 2023-2025 janë bërë hapa përpara lidhur me plotësimin e strukturës sipas ligjit. Nga 6 punonjës që jepnin shërbim në Drejtorinë e kujdesit Social në Bashkinë Sarandë, aktualisht kemi 9 të tillë. Është plotësuar struktura me NJVRN, me Koordinatorin kundër dhunës në mardhëniet familjare dhe DS me një administrator shoqëror.

Përsa i përket Njesisë administrative Ksamil u ngrit NJVRN-ja me ndihmën e ReLOAD një projekt i zbatuar nga UNDP dhe Bashkia Sarandë

Ngelet objektiv që të sigurohet vazhdimësia e shërbimit.

Janë identifikuar vështirësi në kushtet e punës dhe infrastruktura, si dhe burimet e limituara dhe të pamjaftueshme. Rrjedhimisht, ka edhe vështirësi në informimin e qytetarëve, lidhur me të drejtat e tyre për shërbime të kujdesit shoqëror. Nevoja e plotësimit të strukturës me punonjës social të specializuar sipas kërkesave të ligjit, dhe reflektimi i realitetit ligjor në Rregulloren e Bashkisë duhet të konsiderohet prioritet nga ana e Bashkisë Sarandë. Në Bashkinë Sarandë operojnë gjithashtu organizata jo-qeveritare si UNDP me ReLOAD and Leave No One Behind (LNB), Gjithashtu organizata lokale si Fondacioni LIDIA, Shoqata “Jona” dhe Mary Ward Loreto, “Shpresë për Botën” të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në shërbim të komunitetit, grupeve në nevojë dhe në veçanti për fëmijët me aftësi të kufizuar.

1.2.8 Shërbimet e kujdesit shoqëror në Qendrat Komunitare

Bashkia Sarandë dhe Drejtoria e Kujdesit Social, duke u mbështetur në planin social 2023-2025 është përpjekur që të sigurojë shërbime komunitarë për kategori të ndryshme duke marrë një sërë masash për menaxhimin efikas të sigurimit të mekanizmave të mbrojtjes sociale, me qëllim krijimin e një sistem funksional dhe të qëndrueshëm të shpërndarjes së shërbimeve të përkujdesit social.

1. Aktulisht kemi QMZHFFF e ngritur me kontributin e Fondit Social, e cila ofron shërbim për fëmijë nga familje në nevojë, me probleme sociale, viktime të dhunës në familje, por edhe për vet familjen , prindërit duke ofruar këshillim, kurse prindërimi etj. Kjo qendër ka të regjistruar me shërbim ditor 41 fëmijë(25 femra dhe 16 meshkuj) dhe 22 prindër(20 femra dhe 2 meshkuj), por jep shërbim edhe në komunitet duke trajtuar raste, vizita nën shtëpi, aktivitete ndërgjegjësimi për tema të ndryshme etj. Fushëveprimi i saj përfshin:

- identifikim, vlerësim, informim dhe këshillim psiko-mediko-social për fëmijët, individët dhe familjet në nevojë
- shërbime këshilluese
- parandalim i braktisjes, institucionalizimit dhe trafikimit të fëmijëve;
- ofrimi i programeve të fuqizimit të familjes dhe individit;
- ofrimi i ndërhyrjes së hershme për fëmijët me Aftësitë Kufizuar të moshës 0-6 vjeç,
- klasa prindërimi
- klubet e leximit
- si dhe çdo detyrë tjetër të përcaktuar në legjislacionin në fuqi ose të ngarkuar nga Kryetari i

Bashkisë, që lidhen me funksionet e njësive të vetëqeverisjes vendore në fushën e shërbimeve sociale.

2. Qendra e Zhvillimit jep shërbim për fëmijët pak të moshës 4-16 vjeç.

Kjo qendër jep shërbimet:

- e logopedisë, fizioterapisë, terapi zhvillimi,
- këshillim dhe asistencë psikosociale.
- 31 fëmijë(15 femra dhe 16 meshkuj) frekuentojnë këtë qendër dhe ndiqen nga një staf i kualifikuar me asistencën e UNDP programit LNB

Drejtoria e Kujdesit Social në fokus të punës së vet ka planifikimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror që ofrohen në territorin e Bashkisë Sarandë. Në përmbushje të nevojave të individëve në vështirësi social-ekonomike, gjë të cilën synon të zgjerojë hartën e shërbimeve

Qendrat komunitare përgjatë vitit 2024, në synim për të përmbushur në rritje nevojat që qytetit i Sarandës, kanë riparë strukturat e veta duke shtuar staf, që rezulton si më poshtë:

Numri i stafit në Qendrat Komunitare/Sociale

Shërbimi	Numri i punonjësve 2023	Numri i punonjësve 2024	Nevojat per shtime
Qendra MZHFFF	5	7	-
Qendra e Zhvillimit	7	7	2
Qendra DP “ Feti Rugji”	10	10	2

Shërbimet e kujdesit social në struktura të organizuara

Shërbimet të struktura në qendra janë dy të cilat nga pikpamja organizative janë përfshirë në Qendrën komunitare për fëmijët. Këtu ofrohen shërbime për dy kategori atë të fëmijëve nga familje në nevojë dhe me probleme sociale dhe rrezik institucionalizimi dhe Qendra e zhvillimit që jep shërbim për fëmijë PAK 4-16 vjeç, 31 fëmijë (15 femra dhe 16 meshkuj)

1) Qendra multifunkionale e Zhvillimit dhe Fuqizimit të Familjes

Nr	Emërtimi	Emërtimi në strukturën e Bashkisë	Nr aktual	Sipas projektit	
1	Punonjës social	Punonjes social	1	1	
2	Psikolog	Psikolog	1	1	
3	Punonjës social	Punonjës social	1	2	
4	Edukator	Edukator	3	2	
5	Sanitar	Sanitar	1	1	
	Totali		7	7	

Në kuadrin e zbatimit të ligjit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, i cili prezanton modelin e menaxhimit të rastit dhe punës ndërsektoriale, bashkia ka nevojë të zhvillojë një qasje të re me shërbime të qëndrueshme dhe të koodinuara jo me vetëm bazë projekti me qëllim sigurimin afatgjatë të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Menaxhimi financiar i qendres multifunkionale dhe qendres se zhvillimit te jete pjese integrale e struktures se qendres komunitare.

Numri i përfituesve eshte 41 fëmijë (25 femra dhe 16 meshkuj) dhe 22 prindër ose kujdestare(20 femra dhe 2 meshkuj)

2. Qendra e zhvillimit të fëmijëve me aftësi ndryshe

	Qendra e Zhvillimit të fëmijëve me aftësi ndryshe	Emërtimi në strukturën e Bashkisë	Nr aktual	Sipas projektit	Nevojat per shtim
1	Përgjegjës qendre dhe punonjes social	Përgjegjës qendre dhe punonjes social	1	1	

2	Specialist logoped	Specialist logoped	1	1	
3	Specialist psikolog	Specialist psikolog		1	1
4	Specialist fizioterapist	Specialist fizioterapist	1	1	
5	Specialist edukator zhvillimi	Specialist edukator zhvillimi	1	2	1
6	Kujdestar	Kujdestar	1	1	
7	Sanitar	Sanitar	1	1	
	totali		6	8	

Duke pare numrin e fëmijëve dhe ngarkesën e punonjësve përgjegjesi dhe Psikologu mbulojnë me aktivitetet te dyja qendrat.

2. **Qendra polivalente e te moshuarve “Feti Rugji”** e financuar nga Sherbimi Social Shteteror dhe nga Bashkia Sarande me 7 të punesuar qe japin sherbim per 50 te moshuar (11 femra dhe 39 meshkuj), me financim 76% nga Sherbimi social dhe 24% nga bashkia

Nr	Emërtimi	Emërtimi në strukturën e Bashkisë	Nr aktual	Sipas projektit	Nevojat per shtim
1	Drejtor	Drejtor	1	1	
2	Psikolog		0	1	1
3	Punonjës social	Punonjës social	2	2	
4	Specialiste finance	Specialiste finance	1	1	
5	Kujdestar	Kujdestar	3	3	
6	Kuzhinier	Kuzhinier	1	1	
7	Ndihmës kuzhinier	Ndihmës kuzhinier	1	1	
8	Infermier		0	1	1
9	Sanitar	Sanitar	1	1	
	Totali		4	7	

Obiektiv i këtij plani është plotësimi i strukturës me një psikolog dhe një infermier me kohë të pjesshme

4. **Qendra emergjencës 72 orë** për viktimat e dhunës me kapacitet për katër viktima, pa buxhet nga bashkia, shpenzimet deri tani janë përballuar nga shoqata “Jona”. Mesatarisht ne kete qender

trajtohen 6 persona ne vit. Zakonisht jane nëna me fëmijë. Numri i rasteve është ulur pas ndryshimeve ligjore që parashikojnë largimin e dhunuesve nga banesa. Përfituesit janë kryesisht femra me përjashtim të rasteve kur nëna la fëmijë të mitur meshkuj.

1.2.9 Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rasteve (NJVNR)

Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, në nenet 36 dhe 37, ka përcaktuar jo vetëm rolin e Bashkisë në këndvështrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, por edhe strukturat që duhet të ngrihen e të funksionojnë si pjesë e saj, me qëllim që të bëhet funksional një sistem lokal komunitar i këtyre shërbimeve. Në këndvështrimin e ligjit, bashkia duhet të ketë struktura të ngritura në dy nivele:

- a) Struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në bashki;
- b) Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit, e krijuar në nivelin e njësive administrative.

Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NJVNR), është ngritur vetëm në bashkinë qendër pranë Drejtorisë së Kujdesit Social dhe ka në përbërje të saj një përgjegjës që mbulon edhe detyrën e punonjësit social të NJVNR- se, koordinatorin kundër dhunës në familje dhe pmf

Një nga objektivat e këtij plani social është ngritja e NJVNR-se edhe në Njësinë administrative Ksamil. Në këtë drejtim është punuar dhe duke shfrytëzuar edhe një nga projektet ReLoAD kjo njësi u ngrit për një periudhë 8 mujore duke siguruar mjedisin dhe bazën materiale. Mbetet sfida e këtij plani që të plotësohet me staf

Bazuar në nenin 36 të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, bashkia cakton nga 1 punonjës social të njësisë së qeverisjes vendore për 6 deri në 10 mijë banorë. Aktualisht, nqs marrim parasysh të dhënat e Cens 2023 jemi në kufij të përmbushjes të këtij kriteri sasior, por po të marrim parasysh që për të paktën 3 muaj e verës popullsia 3 fishohet dhe nga përvoja shtohen rastet e dhunës në mardhëniet familjare, fëmijët në situatë rruge etj, është e domosdoshme shtimi i një punonjësi social

Gjithashtu nga te dhënat e Cens 2023 kemi 3565 fëmijë të moshës 0-14 vjeç rezident në bashkinë Sarandë, kemi 745 fëmijë të moshës 15-18 vjeç që ndjekin arsimin e mesëm dhe duke marrë parasysh se jo të gjithë të miturit që përfundojnë arsimin e detyrueshëm ndjekin arsimin e mesëm shifra e estimuar e të miturve 0-18 vjeç është rreth 4500 të mitur sipas Cens 2023. Sipas regjistrimit të gjendjes civile ky numër është më i madh. Në këto kushte sipas ligjit 121/2016, nevojiten 2 punonjës pmf

NJVNR, pavarësisht periudhës së krijimit, rrjedhur nga ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, shumë nga detyrat e saj funksionale i ka ushtruar edhe më parë, modeli më i mirë i menaxhimit të rastit erdhi me rolin e Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijës, i cili vepron në përputhje me aktet ligjore të plotësuara në çdo nivel funksional. E njëjta vlen edhe për koordinatorin kundër dhunës në mardhëniet familjare

Specialistët e NJVNR, punonjësit socialë, kanë hasur vështirësi në trajtimin e rasteve, dinamikave të ndryshme që mbartin kategoritë në nevojë, mungesa e akteve ligjore që përcaktojnë detyrimet dhe modalitetet e punës për çdo aktor që duhet të përfshihet në procesin e

menaxhimin e rastit apo edhe vetë formateve të punës. NjVRN ka shfrytëzuar burimet e saj njerëzore, si dhe ka bashkëpunuar me gjithë anëtarët e MKR-së, ETN-së dhe GTN-së për referimin, menaxhimin e rastit. Fakti që mungojnë shërbime në territor sjell pengesa në menaxhimin e rastit. Nga ana tjetër për shërbimet kombëtare gjithashtu ka pengesa pasi kuadri ligjor është i paqartë për disa procedura lidhur me shërbimet që mund të jepen nga qendrat kombëtare.

Rastet hidhen në Regjistrin Elektronik Kombëtar për Menaxhimin e Rastit, i cili ka pasur problem të konsiderueshme teknike për një kohë të gjatë, e ka bërë këtë mekanizëm jo efektiv për njohjen e ecurisë së menaxhimit të rastit. Por gjithsesi ky regjistër mbetet si një regjistër evidentues sepse edhe pse kryen funksionin e referimit, ky referim nuk finalizohet dhe nuk lehtëson procedurat për dhënien e shërbimit apo akomodimit.

Sektori i Mbrojtjes Sociale, gjithashtu ka mundësuar vënien në dispozicion të hartës së shërbimofruesve që veprojnë në territorin e Bashkisë Sarandë, për të lehtësuar procesin e referimit të rasteve drejt shërbimeve.

Plani i Shërbimeve Sociale kërkesë ligjore, por dhe detyrim ndaj shtresave në nevojë

Plani i Shërbimeve Sociale i Bashkisë Sarandë(2026-2028) është një dokument politikash specifike për grupet dhe komunitet e targetuara në territorin e Bashkisë, në përputhje të plotë me Strategjinë e mbrojtjes Sociale 2024-2030 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale miratuar me VKM nr 152 datë 13.03. 2024, Dokumentin e politikave të përfshirjes Sociale 2024-2028 miratuar me Vendim Nr 544 date 28.08.2024 dhe detyrimeve e përgjegjësi qe burojnë nga Ligji per Shërbimet e Kujdesit Shoqëror, si dhe me Paktin Social te firmosur nga Kryetarët e Bashkive të Republikës së Shqipërisë me përfaqësues të Qeverisë, si dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave¹ që sigurojnë legjislacionin sekondar në mbështetje dhe zbatim të ligjeve të sipër-përmendur. Ky Plan do të jetë pjesë përbërëse/integrale e Planit të Zhvillimit të Bashkisë Sarandë dhe në këtë kuadër do t'i mundësojë strukturave vendim-marrëse të Bashkisë

¹Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social”.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr 224/2024 “ Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.

Udhëzimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 689, datë 2.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”.

të përcaktojnë fushat prioritare dhe mobilizimin e burimeve financiare dhe njerëzore të disponueshme.

Plani Social, synon të përmirësojë strukturat institucionale dhe mekanizmat e domosdoshëm administrativë në shërbim të grupeve vulnerabël, të identifikojë kostot indikative dhe burimet financiare, në mënyrë që shërbimet e kujdesit social të ofrohen për familjet, fëmijët dhe grupet e tjera vulnerabël në Bashkinë e Sarandës, sipas një plani të mbështetur në nevojat e identifikuara në territorin e bashkisë Sarandë, i cili monitorohet dhe përditësohet rregullisht. Dokumenti i Planit të Shërbimeve Sociale (PSHS) ka qëllim të orientojë dhe të udhëheqë vendimarrjen e bashkisë për të siguruar çdo mbështetje, institucionale, logjistike dhe financiare ndaj Drejtorisë së Kujdesit Social, shërbimeve ekzistuese me qëllim që grupet vulnerable dhe në nevojë të trajtohen sipas parashikimeve ligjore, me shërbime të koordinuara dhe cilësore të bazuara në nevojat e komunitetit. Vënia në zbatim i planit të veprimit do të sigurojë shërbime të integruara në bazë të shërbimeve aktuale dhe shërbimeve të reja që mund të ngrihen.

Monitorimi, raportimi dhe dokumentimi i progresit të zbatimit të objektivave dhe masave të këtij plani do të paraqitet në mënyrë periodike dhe do të jetë pjesë e diskutimeve të strukturave drejtuese, Këshillit Bashkiak dhe partnerëve të tjerë vendorë.

Përgjegjëse për monitorimin e zbatimit e PSHS do të jetë Drejtoria e Shërbimeve dhe Mbështetjes Sociale (Drejtorja e Kujdesit Social), e cila mbledh të dhëna dhe identifikon boshllëqet në informacionin që nevojitet. Ajo do të ketë gjithashtu rol koordinues dhe bashkërendues mbi ecurinë e zbatimit dhe do të ketë përgjegjësinë e përgatitjes së progres raporteve vjetore. Në lidhje me monitorimin dhe kordinimin, plani parashikon veprimtari të përmirësimit të sistemit të të dhënave, hartimit të instrumentave të standartizuara të raportimit, si dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit me strukturat e nivelit rajonal, qendror dhe OJF-të.

Shërbimet e kujdesit shoqëror për qytetarët të Bashkisë Sarandë

Reforma e ndërmarrë në fushën e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, ndryshimet ligjore dhe Ligji i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror dhe VKM-të në zbatim të tij kanë rritur dhe ngarkuar drejtpërdrejt Bashkinë me përgjegjësinë për të adresuar efektivisht nevojat për shërbime të gjithë kategorive në nevojë. Në trevjeçarin e kaluar jemi përpjekur për të ndryshuar modelin e ofrimit të shërbimeve duke synuar shërbime të integruara dhe jo vetëm NE dhe pagesa paaftësie, gjë që arrihet përmes modelit të menaxhimit të rastit dhe punës ndërsektoriale, si në nivel bashkie ashtu edhe NJA-ve, duke përdorur e kombinuar burimet e aktorëve të ndryshëm relevantë publikë dhe jopublikë.

Hapi i parë për të zbatuar ligjin dhe për sigurimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë e Sarandës, mbetet zbatimi i ligjit për plotësimin e strukturës dhe stafit të DKS dhe të Njësisë e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave, si në Sarandë, ashtu dhe në Ksamil. Plotësimi me

punonjës social dhe mjete logjistike duhet bërë për të garantuar mbulimin dhe menaxhimin më efektiv të rasteve në të gjithë territorin dhe koordinim më të mirë me insitucionet e tjera bashkiake, apo dhe në nivel rajonal (si shëndetësia, arsimit, policia).

Pamjaftueshmëria e burimeve njerëzore dhe trajnimi, kualifikimi i stafëve vazhdon të mbetet çështje për tu adresuar edhe në këtë Plan Social. Plotësimi i këtyre nevojave do ta bënte më të lehtë punën e stafit të shërbimeve të kujdesit social, por do ta bënte edhe më profesional koordinimin e mbështetjes për grupet në nevojë edhe me donatorët dhe OJF-të që do mund të angazhoheshin në këtë veprimtari në Bashkinë Sarandë e gjithë kjo do garantonte shërbim në kohë dhe cilësor për qytetarët e Sarandës që i përkasin grupeve vulnerabël.

Bazuar në vlerësimin e nevojave për shërbime në territorin e Bashkisë Sarandë, i cili është realizuar përmes konsultimit me stafin e bashkisë, ofruesit e shërbimeve apo partnerë dhe institucione relevante, si dhe mbi shportën e shërbimeve bazë, janë hartuar prioritetet e bashkisë Sarandë në zhvillimin e shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror dhe atyre të reja, të prezantuara më poshtë. Disa priorite janë të njëjta edhe në planin 2023-2025. Ky është indikator të një progresi të ngadaltë dhe të vështirë. Disa nga aktivitetet e planit të mëparshëm nuk janë realizuar dhe do të vazhdojnë të jenë të planifikuara edhe në këtë plan ndërkohë që aktivitete si plotësimi i stafit me koordinatorin kundër dhunës, shërbimi në shtëpi për të moshuarit janë realizuar dhe sfidë ngelet sigurimi i vazhdimësisë së projekteve. Plani i veprimit 2026 -2028 vazhdon të mbështetet dy shtylla kryesore, atë të zhvillimit dhe përmirësimit të shërbimeve ekzistuese, dhe atë të krijimit dhe zhvillimit të shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror.

2.1 Prioritetet në zhvillimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor

2.1.1 Zhvillimi i shërbimeve ekzistuese:

- Fuqizimi i strukturave publike në Bashkinë Sarandë me staf në nivel të punonjësve socialë dhe atyre psiko-socialë, riorganizimi i dhe ristrukturimi i shërbimeve shoqërore dhe buxhetimi/financimi i menaxhimit të asistimit;
- Riorganizimi i punës për Njësinë e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave, Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve, koordinatorin kundër dhunës në familje.
- Përforcimi i praktikave për regjistrimin e rasteve të trajtuara dhe atyre që kanë bërë kërkesa për krijimin e databazave, duke përdorur sistemin SHKSK, REVALB.
- Konsolidimi i shërbimeve për të moshuarit, përmirësim i shërbimit dhe shtimi i kapacitetit
- Sigurimi i vazhdimësisë së Qendrës MZHFFF – ambiente të përshtatshme dhe materiale që ndihmojnë në zhvillimin e aktiviteteve psiko -sociale si dhe personel ku ofrohen shërbime të integruara për të gjitha kategoritë vulnerabël, si për fëmijët dhe të rriturit.

- Vazhdimesia e mbeshtjetes se familjeve ne nevoje me heqjen e tarifes se kopshtit.
- Mbështetje logjistike për shërbime për viktimat e dhunës në mardhëniet familjare dhe viktimat e mundshme (transport, shpenzime emergjente).
- Funksionimi i qendrës emergjente 72 orë për viktimat e dhunës në mardhëniet familjare.
- Fuqizimi i komunitetit Rom me shërbime egzistuese dhe ngritja e shërbimeve të reja për këto komunitet me fokus kryesor integrimin e tyre në jetën social-ekonomike.
- Trajtim nga të ardhurat e bashkisë për familjet me probleme sociale dhe me probleme në përbërjen familiare pasi ky komunitet dallohet për martesat në moshë të hershme.
- Konsolidimi dhe përmirësimi i shërbimit duke patur si objekt edhe shtresat në nevojë në Qendrën rinore, si një arritje planit social 2022-2025.

2.1.2 Zhvillimi i shërbimeve të reja:

- Përmirësimi i shërbimit ditor për moshën e tretë në Ksamil sipas standarteve. Shërbimi në shtëpi për grupmoshën e tretë dhe grupe të tjera vulnerabël sipas vlerësimit të nevojave, fëmijë dhe të rinj me PAK.
- Ngritja e një shërbimi mbështetës për fëmijët e komunitetit rom duke u ofruar një minivakt, pranë shkollës 9-vjeçare Çukë me qëllim nxitjen e frekuentimit të rregullt të shkolles.
- Fuqizimi i qendrës komunitare me shërbime për fëmijën dhe familjen (mbështetje në procesin e menaxhimit të rastit për fëmijën dhe familjen, sesione të disiplinës pozitive me prindër dhe kujdestarë, aktivizimin e të rinjve dhe fëmijëve për të advokuar mbi çështjet e të drejtave të fëmijëve si dhe respektimin e tyre duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijës. Mbështetje me paketa ushqimore, higjienosanitare dhe shpenzime emergjente për viktimat dhe viktimat e mundshme të dhunës në mardhëniet familjare
- Pasurimi me shërbime të trajtimit të personave me aftësi të kufizuara, terapi zhvillimi, terapi okupacionale, shërbime rehabilitimi në Qendrën e Zhvillimit dhe shërbime në shtëpi përmes angazhimit të specialistëve të fushës të cilët mund të ofrojnë shërbime të lëvizshme dhe/ose në ambiente të përshtatshme për të rinjtë nga moshën 16 -28 vjeç dhe të miturit në NJA Ksamil

Plani Social i Bashkise Sarandë nuk synon te siguroje vetëm zbatimin e ligjit, por dhe garantimin dhe mbrojtjen e jetës dhe dinjitetit të qytetareve të Sarandës që përfitojnë nga shërbimet e kujdesit shoqëror.

2.2.1 Qëllimi A i planit lokal është të fuqizojë sistemin e shërbimeve sociale në nivel lokal për të përmirësuar mirëqenien e çdo individit nëpërmjet shërbimeve ekzistuese si dhe duke ofruar shërbime të reja bazuar në nevojat dhe dinamikat e secilit rast në nevojë në Bashkinë Sarandë.

Objektivi strategjik 1. Fuqizimi, mirë-strukturimi, organizimi, koordinimi, vlerësimi dhe pasurimi i shërbimeve sociale në Bashkinë Sarandë

Kjo do të arrihet përmes fuqizimit të Sektorit të Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale duke kryer plotësimin me staf sipas sipas nevojave dhe kërkesave ligjore brenda drejtorise ekzistuese te shërbimeve sociale; gjithashtu do të kryhet ngritja e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në çdo njësi administrative, duke rishikuar strukturën për çdo njësi administrative sipas numrit të popullsisë dhe nevojave për shërbime. Nevojat për staf dhe shërbime përcaktohet nga analiza e situatës në terren dhe të dhënat për popullsinë sipas Cens 2023.

Objektivi strategjik 2 - Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë

Mbështetja dhe fuqizimi i familjeve në nevojë do të kryhet përmes identifikimit i familjeve aplikante, të cilat nuk përfitojnë nga skema e NE, qartësimi dhe transparenca e kriterëve për përzgjedhjen e familjeve që do të përfitojnë nga 6% dhe fondet e Bashkisë në përputhje me vendim-marrjen e përmuajshme². Riaftësim profesional për integrim në tregun e punës sidomos për nënat kryefamiljare si dhe sesione prindërimi.

Objektivi strategjik 3. Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara

Fuqizimi i shërbimit ndaj fëmijëve me AK në qendrën ditore duke shtuar një vakt për fëmijët që trajtohen aty. Do synohet integrimi i programeve të mbështetjes financiare për AK me shërbimet të kujdesit shoqëror për fëmijët dhe të rriturit duke synuar ngritjen e një modeli pilot të ofrimit të shërbimeve për personat PAK në qendrën ditore përmes ngritjes së shërbimeve të trajtimit të

personave me aftësi të kufizuar, terapi zhvillimi, terapi okupacionale, shërbime rehabilitimi dhe shërbime në shtëpi përmes angazhimit të specialistëve të fushës të cilët mund të ofronin shërbime të lëvizshme dhe/ose në ambiente të përshtashme. Do aplikohet konceptimi i modeleve dhe kostimi i tij; zbatimi i modelit.

Objektivi strategjik 4 - Kualifikimi i stafit dhe përmirësimi i politikëbërjes, vendimmarrjes dhe planifikimit në fushën e shërbimeve shoqërore përmes mbështetjes në evidenca.

Përmes trajnimeve synohet rritja kapaciteteve të stafit për ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, mbi funksionimin e NJVRN, zbatimin dhe monitorimin e Fondit Social, funksionimin e shërbimit të Strehëzës së emergjences, funksionimin e Qendrës Multifunksionale etj. Mbledhja të dhënave sociale, përpunimi i tyre në mënyrë të qëndrueshme. Shrytëzimi i të dhënave të sistemit të menaxhimit të NE dhe sistemit të të dhënave për komisionimin bio-psikosocial.

Nga ana tjetër përdorimi dhe shfrytëzimi i të dhënave në systemin SHKSH. Trajnime për përdorimin e evidencave në vendimmarrje/planifikim etj.

2.2.2 Qellimi B Garantimi i shërbimeve sociale të integruara, të aksesueshme duke respektuar barazinë gjinore, vulnerabilitetin dhe parimin e deinstitutionalizimit

Objektivi strategjik 1. Mbrojtja e fëmijëve dhe e të drejtave të tyre, parandalimi i institucionalizimit

Për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve dhe potencimin e tyre synohet fuqizimi i NjMF dhe administratorëve socialë në cdo njësi të bashkisë si dhe ngritjes dhe fuqizimit të Njësisë së Vlerësimit dhe Referimit të Rasteve duke kryer ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore ekzistuese dhe atyre që do të kontraktohen të rinj, si dhe duke përmirësuar koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit midis institucioneve lokale përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve. Përgatitja e planeve sa i përket aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere për mbrojtjen e fëmijëve në të gjitha institucionet, si dhe rritja e kapaciteteve profesionale dhe logjistike të DSHMS për identifikimin e rasteve të fëmijëve në nevojë. Shërbime të integruara në qendra komunitare dhe në bashkëpunim me OJF-të

Objektivi strategjik 2. Përmirësimi i shpërndarjes dhe aksesit të shërbimeve të kujdesit social duke u fokusuar në diversifikimin, barazinë gjinore dhe mbrojtje të garantuar për viktimat dhe viktimat e mundshme të dhunës në mardhëniet familjare.

Për të garantuar barainë gjinore dhe mbrojtje mbrojtje të për viktimat dhe viktimat e mundshme të dhunës në mardhëniet familjare si dhe parandalim të këtij fenomeni shumë shqetësues të shoqërisë DKS, NJVRN përveç menaxhimit të rasteve, ndërgjegjësimi, bashkëpunimi me OJF-

të që operojnë në këtë fushë , në bashkëpunim me drejtorinë ekonomike do të ofrojnë edhe ndihma konkrete materiale dhe financiare për shërbime emergjente për këtë kategori.

Në fushë ne barazisë gjinore mbetet përparësi trajnimi, njohja e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore 2021-2030 nga gjithë stafi që operon në fushën e Shërbimeve Sociale.

Objektivi strategjik 3 – Përmirësimi i cilësisë së jetesës për moshën e tretë në përputhje me planin e moshimit.

Në Bashkinë Sarandë si në shumë qytete të tjera të Shqipërisë është vënë re një rritje e moshës së tretë si dhe plakje e popullsisë si pasojë e numrit të ulët të lindjeve dhe largimi i të rinjve në emigracion duke lënë të moshuarit pa të afërm. Shërbimet për këtë target grup janë shumë të pakta edhe për faktin se kulturalisht shërbimet për këtë moshë janë ofruar gjithmonë nga anëtarët e familjes. Ky objektivi do të realizohet nëpërmjet fuqizimit dhe rritjes së kapacitetit të Qendrës ekzistuese Ditore për të Moshuar si dhe pasurimit të aktivitetit social të saj në Ksamil. Gjithashtu do synohet që të vazhdojë dhënia e shërbimit në shtëpi -për të moshuar e cila u implementua me sukses për vitin 2024-2025 men kontributin e UNDP programi LNB.

2.3 Strategjia e zbatimit të planit social

Zbatimi

Zbatimi i Planit Social është detyrë e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale . Për zbatimin e Planit Social ky sektor kërkon dhe siguron bashkëpunimin dhe koordinimin me të gjithë aktorët institucionale në nivel vendor dhe kombëtar, publikë dhe jo-publikë. Për realizimin e tij një kontribut të veçantë dhe thelbësor duhet të japë Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e projekteve.

Raportimi

Raportimi mbi zbatimin e Planit Social do të realizohet në bazë të raporteve periodike, 6 mujore dhe vjetore të monitorimit dhe vlerësimit nga DKS në bashkëpunim edhe me organizatat lokale. Një nga raportimet rutinë , është raportimi ne Këshillin Bashkiak

Monitorimi dhe vlerësimi

Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit është të sigurojë që Plani Social i Bashkisë Sarandë po zbatohet sipas afateve dhe synimeve të caktuara dhe për të kontrolluar pajtueshmërinë e standardeve të përcaktuara me ato që po zbatohen në realitet.

Monitorimi është procesi i vazhdueshëm i mbledhjes së të dhënave dhe matjes së progresit drejt arritjes së objektivave strategjike dhe specifike të këtij Plani Social. Monitorimi dhe vlerësimi është një pjesë e menaxhimit të mirë të programit dhe llogaridhënies. Përmes monitorimit, zbatuesit dhe aktorët përgjegjës për këtë plan sigurohen që aktivitetet që kryhen janë në përputhje me ato të planifikuara dhe brenda afateve kohore të përcaktuara. Gjithashtu monitorimi parashikon edhe marrjen e masave korrigjuese , përditësim të nevojave dhe krijimin

e database për planet në vazhdim duke kërkuar dhe përditësuar informacion nga tre fusha kryesore:

- Inputet, burimet që përdoren për realizimin e planit, që përfshijnë stafin, financat, materialet dhe kohën;
- Proceset, numri i aktiviteteve ku përdoren burime njerëzore dhe financiare për të arritur rezultatet e pritshme të planit;
- Outpute/produkte/shërbime, rezultatet e menjëhershme që përftohen përmes realizimit të aktiviteteve.

Monitorimi i zbatimit të Planit Social të Bashkisë Sarandë do të kryhet nga Drejtoria e Kujdesit Social në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe antarë të këshillit bashkiak. Afatet kohore të monitorimit do të vendosen nga njësia përgjegjëse në varësi të kohëzgjatjes së çdo aktiviteti përgjatë vitit kalendarik.

Rreziqet për zbatimin e planit

Me gjithë përpjekjet për të hartuar një plan shërbimesh sociale bazuar në nevojat e identifikuara si dhe motivimin e Bashkisë për ta bërë atë të zbatueshëm, duhen marrë në konsideratë edhe disa rreziqe që mund të hasen gjatë këtij procesi.

- Rreziku i përsëritur, që përkeqëson cilësinë dhe numrin e shërbimeve për grupet në nevojë, lidhet me pretendimin për burime të kufizuara financiare të bashkisë, si dhe me realitetin e burimeve njerëzore të pamjaftueshme të DKS.
- Edhe në vlerësimin paraprak të situatës janë theksuar mungesat e stafit të specializuar si në numër dhe në kapacitetet profesionale për t'iu përgjigjur me shërbime të përshtatshme nevojave reale dhe komplekse të grupeve në nevojë.
- Një rrezik tjetër për zbatimin e planit mund të paraqitet lidhur me ndryshime eventuale në struktura dhe stafe, veçanërisht në periudhat e zgjedhjeve politike vendore dhe qendrore .
- Njën rrezik tjetër është mungesa e profesionistëve në tregun e punës pasi vihet re dukuria e qëndrimit në kryeqytet të të sapodiplomuarve. Një nga shtyllat e planit është dhënia e shërbimeve nga profesionistë si psikologë, logopedë, fizioterapistë dhe përvoja ka treguar që ka mungesa në territorin e bashkisë Sarandë.

Aneks1: PLANI I VEPRIMIT 2026- 2028

Qëllimi A. Fuqizimi i sistemit të shërbimeve sociale në nivel lokal për të përmirësuar mirëqenien e çdo individi në nevojë nëpërmjet shërbimeve ekzistuese si dhe ngritjen e shërbimeve të reja.

Objekti Strategjik 1 – Fuqizimi, mirë-strukturimi, organizimi, koordinimi dhe vlerësimi i shërbimeve shoqërore ekzistuese në Bashkinë Sarandë

Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Afatet	Treguesit e monitorimit	Burimi i të dhënave	Financimi/lek indikativ	Monitorimi
OS. 1.1. Ndërtimi dhe forcimi i njësisë (drejtorisë) së shërbimeve sociale/shoqërore në Bashkinë Sarandë						
Konsolidimi i organigramës së Bashkisë Sarandë duke forcuar NJVRN në Drejtorisë së Shërbimeve Sociale Shtim i nje punonjësi social në këtë njësi	Bashkia Sarandë Drejtoria e personelit dhe burimeve njerëzore	2026–2028	Numri i shtuar i stafit të Drejtorisë së Shërbimeve dhe Mbështetjes Sociale në Bashkinë Sarandë Nje staf i shtuar	Organigrama, Bashkia Sarandë	3,800,000 Kosto per tre vjet	Këshilli Bashkia Sarandë
OS 1.2. Ngritja e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në çdo njësi administrative						
Rishikimi i strukturës për njësinë administrative sipas numrit të popullsisë dhe nevojave për shërbime me fokus shtimin e shërbimeve ne Ksamil	Bashkia Sarandë Njesia Administrative Ksamil Drejtoria e personelit dhe burimeve njerëzore	2026-2028	Raportet e vlerësimit të nevojave për çdo njësi. Ndryshimet specifike nëstrukturën e secilës njësi. Ngritja e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NJVNR) Ksamil; vlerësimi i efikasitetit sipas numrit të rasteve të menaxhuara fëmijë dhe familje	Bashkia Sarandë	3,521,935 Kosto per tre vjet	Këshilli Bashkia Sarandë;
Shtimi i stafit të punonjësve socialë në Bashkinë Sarandë	Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Bashkia Sarandë	2026 – 2028	Nr i stafit të shtuar Nje punonjë tjetër per barazine gjinore	Bashkia Sarandë	3,000,000	Këshilli Bashkia Sarandë;
OS 1.3. Ndërtimi i hartës të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror						
Pasurimi dhe përditësimi hartës së shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror në nivel Bashkie	DKS NJVRN	2026-2028	Hartat e çdo njësie; pasurimi i tyre vit pas viti; elementet përbërës.	Zyra e Shërbimeve dhe Mbështetjes Sociale, Bashkia Sarandë	Pa kosto	Organizata Bashkia Sarandë;

njësie administrative;						
Përditësimi periodik i vlerësimit i nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror në çdo njësi administrative Follow up i rasteve të menaxhuara	DKS Bashkia Sarandë Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Qendra komunitare që ofron shërbim ditor për fëmijë nga familje nën nevojë dhe Qendra e zhvillimit	2026-2028 (Cdo vit)	Raportet e vlerësimit të nevojave për secilën njësi administrative; treguesit përbërës të tyre	Drejtoria e Shërbimeve dhe Mbështetjes Sociale, Bashkia Sarandë Qendra Komunitare për fëmijë Qendra polivalente për të moshuar	Pa kosto	Keshilli Bashkia Sarandë;
OS 1.4. Zhvillimi i monitorimit dhe vlerësimit						
Krijimi i praktikave dhe konsolidimi i procedurave për prokurimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, sipas kuadrit rregullator	DKS Drejtoria Ekonomike; Drejtoria Juridike Njësia e prokurimit	2026-2028	Nr. i rasteve të prokurimeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror; Dokumentimi i procedurave	Bashkia Sarandë	Pa kosto	Këshilli Bashkia Sarandë;
OS 1.5 Hartimi i projekteve për të perfutur nga instrumenti i fondit social	Drejtoria e Shërbimeve dhe Mbështetjes Sociale Drejtoria Ekonomike Drejtoria e turizmit, projekteve dhe Integrimit European	2026 – 2027-2028	Numri i projekteve të fituara	Bashkia Sarandë	Pa kosto	Bashkia Sarandë;

Objektivi strategjik 2 – Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë, përmirësimi i mirëqenies sociale nëpërmjet ndihmës konkrete financiare dhe shërbimeve të integruara

Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Afatet	Treguesit	Burimi i të dhënave	Financimi/lek indikativ	Monitorimi
OS 2.1. Mbështetja dhe fuqizimi i familjeve në nevojë						

Identifikimi i familjeve aplikante, të cilat nuk përfitojnë nga skema e NE	DKS	2026-2028	Statistikat e disagreguara mbi aplikuesit, fituesit dhe jofituesit.	Sistemi elektronik i NE	Pa kosto	DKS, OJF dhe antare te keshillit bashkiak
Përcaktimi i një fondi të dedikuar për emergjenca te shërbimeve shoqerore (menaxhim rasti)	Bashkia Sarandë Drejtoria financës	2026 2028	Masa e fondit, raportet financiare mbi përdorimin e tij	Bashkia Sarandë Donatorë	500,000 lek ne vit	DKS,OJF dhe antare te keshillit bashkiak
Koordinim dhe bashkëpunim midis strukturave të bashkisë, Zyrat e punës, ojf-ve me qëllim përgatitjen dhe integrimin e shtresave në nevojë në tregun e punës	Drejtoria e kujdesit Social ZVAKPA		Zbatimi i marreveshjes se SHSSH dhe ZVAKPA per referimin e perfituesve te NE per punesim Zhvillimi i takimeve te perbashkëta Mbështetje psikologjike dhe këshillim për motivimin e perfituesve te NE per tu integruar në tregun e punës Organizimi i trajnimeve , workshopeve etj	Bashkia sarande Zyra e Punes organizata	Pa kosto	DKS dhe antare te keshillit bashkiak
OS 2.2. Mbështetja e nënave kryefamiljare/baballareve kryefamiljar						
Ofrimi i kurseve të prindërimit pozitiv per riaftesimin e nenave kryefamiljare (në Qendren Multifunkzionale) Sesione të disiplinës pozitive	Bashkia Sarandë	2026 2028	Numri i nënave/baballareve kryefamiljare të trajnuara	Bashkia Sarandë	Pa kosto shtesë QMZHFFF e ka stafin e nevojshëm për këtë lloj shërbimi	Bashkia Sarandë ZVAKPA

Mbështetja me NE nga të ardhurat e Bashkisë, paketa ushqimore ose detergjentë sipas rastit	Bashkia Sarandë	2026 2028	Numri i perfituesve te NE Numri i paketave të shpërndara	Bashkia Sarandë	1400000 leke ne vit NE(e perfshire ne fondin vjetor) 1,050,000 leke ne vit (paketa)	Këshilli DKS Drejtoria e finances
Vazhdim i mbështetjes financiare per pagesat e çerdhes dhe arsimit parashkollor për të miturit më rrezik .	DKS NJVRN DAMF		Numri i perfituesve	Dks Drejtoria e arsimit dhe menaxhimit financiar	160,000 leke ne vit	Këshilli DKS Drejtoria e finances
Bashkeveprim dhe referim ne institucione te tjera per sherbime	Bashkia Sarandë		Nr i rasteve te referuara Nr i sherbimeve te marra	Bashkia Sarandë Zyra e punesimit	Pa kosto	Bashkia Sarandë ZVAKPA OJF
OS 2.3. Mbështetja me ndihmë ekonomike nga të ardhurat e bashkisë						
Ndihmë ekonomike për familjet që përjashtohen nga skema e ndihmës ekonomike	Bashkia Sarandë	2026 2028	Numri i përfituesve me ndihmë ekonomike rreth 40 familje	Bashkia Sarandë nga buxheti i saj	4,500 000 në vit Bashkia Sarandë nga buxheti i saj	Këshilli Drejtoria e financës
Mbështetje financiare për rastet emergjente	Bashkia Sarandë	2026 2028	Nr i rasteve	Bashkia Sarandë nga buxheti i saj	400,000 ne vit Bashkia Sarandë nga buxheti i saj	DKS Drejtoria e finances

Objektivi Strategjik 3 – Permiresimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuar

Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Afatet	Treguesit	Burimi i të dhënave	Financimi/lek indikativ	Monitorimi
-------------	--------------------	--------	-----------	---------------------	-------------------------	------------

OS 3.1. Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuar

Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve (terapi zhvillimi, terapi okupacionale, shërbime rehabilitimi për personat me AK në qëndrën ditore duke shtuar dhënien e nje vakti ushqim për klientet e qendres.	Bashkia Sarandë DKS QZH	2027 - 2028	Rreth 25 femije do te trajtohen me nje vakt ushqimor, ne përputhje me planin individual terapeutik.	Bashkia Sarandë	5,500,000 ne total per nje vit Donatore; OJF dhe aktore te tjere	Bashkia Sarandë
Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve (terapi zhvillimi, terapi okupacionale, shërbime rehabilitimi për personat me AK duke shtuar Nje mjet transporti dhe baze materiale	Bashkia Drejtoria ekonomike	2027 2028	Numri i vizitave Numri i personave qe marrin sherbim	DKS Qendra e Zhvillimit	2000000 leke	Bashkia Këshilli
OS 3.2 Zhvillimi i terapive okupacionale, shërbime rehabilitimi, shërbime në shtëpi,të lëvizshme me fokus 16 – 28 vjecar 35 – 50 persona _PAK do të marrin shërbim nw Bashkinë Sarandë 8-10 të mitur PAK do të marrin shërbime në banesë në NJA Ksamil	Bashkia Drejtoria Ekonomike Fondi Social NJA Ksamil		Numri i personave me AK i trajtuar si dhe target grupi 16 - 28 vjecar Target grupi 3-16 vjeç në Ksamil Numri i sherbimeve te ofruara (logopedi, fizioterapi, sherbim psikosocial) Numri i personave të referuar për shërbime të tjera	Bashkia Sarande	22,058,220 leke per tre vjet 13,216.972fondi social 8,841,248 Bashkia Donatore	MSHMS Bashkia Sarandë OJF Keshilli DKS
OS 3.1 Bashkërendim dhe referim ne Zyren rajonale te punesimit , per te perfituar nga programet e punësimit për personat AK	Bashkia Sarande ZVAKPA Komisioni Biopsikosocial		Nr i personave te referuar Nr i personave te angazhuar ne programet e punesimit	Bashkia Sarande Zyra rajonale e punesimit	Pa kosto shtese	Bashkia Sarandë OJF Keshilli SHKSH

Objektivi strategjik 4– Kualifikimi i mëtejshëm i stafit të angazhuar në ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve shoqërore

Aktivitetet	Aktorëpërgjegjës	Afatet	Treguesit	Burimi i të dhënave	Financimi/lek indikativ	Monitorimi
OS 4.1. Rritja e kapaciteteve të stafit për ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror						
Trajnime mbi: funksionimin e NJVRN, Zbatimin dhe monitorimin e Fondit Social, analizë e modelit pilot të ofrimit të shërbimeve në familje për të moshuar, funksionimin e shërbimit të Strehëzës, funksionimin e modelit biopsikosocial për personat PAK.	MSHMS, Shërbimi Social Rajonal, Bashkia Sarandë	2026-2028	Nr aktiviteteve, nr i përfituesve, rezultatet e pjesëmarrjes.	MSHMS, Shërbimi Social Rajonal, Bashkia Sarandë	500,000	MSHMS, Shërbimi Social Rajonal, Bashkia Sarandë
OS4.2. Fuqizimi i NjMF dhe administratorëve socialë në cdo njësi						
Ngritja e kapaciteteve të administratorëve socialë; trajnime, mentorime sipas nevojave Hartimi i planeve individuale per personat PAK	Sherbimi Social Shtetëror Agjencia Kombëtare për	2026-2028	Nr i aktiviteteve, nr i pjesëmarrësve, larmishmëria e tematikave	Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve;	300, 400	MSHMS, Shërbimi Social Rajonal,

Fuqizimi i NJVNR dhe rekrutimi i burimeve njerzore	Mbrojtjen e Fëmijëve OJF			Bashkia Sarandë		Bashkia Sarandë Drejtoria rajonale e SHSSH
<i>OS 4.3. Krijimi i kulturës dhe rritja e kapaciteteve për mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave sociale në mënyrë të qëndrueshme</i>						
Ngritja e sistemit të regjistrimit të aplikimeve/ nevojave me të dhëna sa më të disagreguara dhe Trajnime për përdorimin e evidencave në vendimmarrje/planifikim	MSHMS Bashkia Sarandë	2026-2028	Niveli i disagregimit sipas numrit të nëndarjeve Nr i aktiviteteve, nr i pjesëmarrësve	Bazat e të dhënave, Bashkia Sarandë	Pa kosto	Bashkia Sarandë SHSSH

Qellimi B. Garantimi i shërbimeve sociale të integruara të aksesueshme duke respektuar barazinëm gjinore vulnerabilitetin dhe parimin e deinstitutionalizimit

Objektivi strategjik 1– Mbrojtja e fëmijëve dhe e të drejtave të tyre parandalimi i insitucionalizimit te tyre në përputhje me Strategjinë kombëtare të deinstitutionalizimit.

Aktivitetet	Aktorëpërgjegjës	Afatet	Treguesit	Burimi i të dhënave	Financimi/lek indikativ	Monitorimi
OS 1.1 Përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësi të stafit të angazhuar në role dhe detyra për Mbrojtjen e Fëmijëve						
Operimi i qendrës Multifunkionale funksionale në nivel bashkie dhe NJA	MSHÇS Bashkia Sarandë / Zyra e Shërbimeve dhe Mbështetjes Sociale NJA OJF “ Shpresw pwr Botwn”	2026- 2028	50 femije perfitues 7 staf (6 te specializuar dhe 1 ndihmes) 25 të rritur(prinder dhe familje)	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji për shërbimet ekujdesit shoqëror	Per 1 vit 8,770,000 6,641,500 leke nga buxheti i bashkise 2128500 Nga fondi social	OJF dhe antare te keshillit bashkiak MSHMS;
OS1.2 Ngritja e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimi i institucioneve dhe publikut të gjerë për mirëqenien e fëmijëve dhe deinstitutionalizimin	MSHMS SHSSH DKS NJVRN SVK Shtwpia e fëmijës	2026 2028	Aktivitete te realizuara Profesioniste te trajnuar	Plani kombëtar i DEI	Pa kosto shtese	MSHMS SHSSH OJF
OS 1.3 Shërbime sociale dhe të integruara për ndërhyrje të hershme dhe parandalimin e ndarjes së fëmijës nga mjedisi familjar (përfshirë fëmijët me AK)	Bashkia Sarandë DKS NJVRN pmf QMZHFFF QZH	2026 2028	Numri i GTN Nr i rasteve te menaxhuara Nr i fëmijëve qe marrin sherbime dhe parandalohet	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e	Pa kosto shtesë	MSHMS Komiteti drejtuee i DEI SHSSH

			institucionalizimi Numri i familjeve tw fuqizuara	fëmijëve” Ligji për shërbimet ekujdesit shoqëror Plani kombëtar DEI		
OS 1.2 Funkionimi i vazhdueshëm i qendrës së emergjencës/pritëse për rastet viktimave të dhunës në familje me fëmijë etj, në nevojë për mbrojtje (24/7 me kapacitet 2-4 shtretër) <i>(brenda hapësira vetë qendrave komunitare publike, institucioneve të tjera publike vendore, OJF-ve bashkëpunuese, sa herë që është e mundur, apo në mungesë të sigurimit të tyre, përmes marrëveshjeve me ofrues jopublikë të shërbimeve).</i>	DKS OJF	2026- 2028	Dokumenti i modelit të shërbimit	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji për shërbimet e kujdesit shoqëror	100000 lekë Per shpenzime emergjente	Bashkia Sarandë; OJF dhe antare të keshillit bashkiak
OS 1.3 Krijimi i bazës logjistike të nevojshme për strukturat përgjegjëse për realizimin me efektivitet të menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje <i>(sigurimi i hapësirave – zyrë, pajisje, si kompjuter, printer, etj., dhe i mjeteve të transportit dhe komunikimit).</i>	Bashkia Sarandë DKS Drejtoria e Finances	2026- 2028	Zyra e PMF përmban pajisje zyre-kompjuter, printer, mjedis miqësor për fëmijët, telefon, transport si dhe realizon intervista në respekt të privatesise së rastit (femije dhe familje) Numri i mjeteve të transportit dhe sasia e karburantit në dispozicion në raport me nevojën për identifikim të rasteve (zona e mbulimit, numri i fëmijëve në nevojë); Mjetet e komunikimit në dispozicion (telefon, kartë, numër telefoni me kontratë), në raport me nevojën	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve	894,000	Bashkia Sarandë; -OJF dhe antare të keshillit bashkiak

			përkomunikim			
OS 1.4 Fuqizimi i shërbimeve sociale të integruara me qëllim mbështetjen e familjeve të fëmijëve në proces deinstitutionalizimit	Bashkia Sarande NJVRN QMZHFFF Shtëpia e fëmijës shkollor Sarandë		Mbledhje të GTN Nr i familjeve të mbështetura Nr i fëmijëve në rrezik institucionalizimi	Plani kombëtarar i DEI Vendimet e Komitetit Drejtues	100000 leke ne vit	Bashkia Drejtoria e Kujdesit Social Këshilli
OS 1.5 Funksonimi i qendres komunitare brenda ambiente të QMZHFFF bashkine Sarande	DKS QZHFFF	2026-2028	Qender e dedikuar për fëmijet dhe familjet – mbështetje për procesin e menaxhimit të rastit – aktivitete të ndryshme mbi prindërimin, përfshirjen sociale dhe mobilizimin e komunitetit	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve	Pa kosto shtesë	Bashkia Sarande - OJF dhe antare të Keshillit Bashkiak
OS 1.6 Krijimim i një shërbimi mbështetës për fëmijët nga shtresat në nevojë, prane shkolles 9-vjeçare Çuke, duke siguruar një minivakt në pushimin e gjatë me qëllim parandalimin e braktisjes së shkollës	Bashkia Sarande OJF	2026-2028	Shërbim i ri minivakt pranë shkolles 9-vjeçare Çuke për fëmijet nga familje në nevojë, kryesisht komuniteti rom Numri i fëmijëve përfitues 30 fëmijë	Strategjia Kombëtare e shërbimeve sociale	1.500.000 leke ne vit 4.500.000 lekë në 3 vite	Bashkia Sarande OJF

Objektivi strategjik 2 – Përmirësimi i shpërndarjes dhe aksesit të shërbimeve të kujdesit social duke u fokusuar në diversifikimin, barazinë gjinore dhe mbrojtje të garantuar për viktimat e mundshme të dhunës në mardhëniet familjare.

Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Afatet	Treguesit e monitorimit	Burimi i të dhënave	Financimi/lekë indikativ	Monitorimi
OS OS 2.1 Përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësi të stafit të angazhuar në role dhe detyra për barazinë gjinore dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në mardhëniet						

<i>Përmbushje e detyrave sipas percaktimeve ligjore dhe përshkrimit në rregulloren e bashkisë</i>	Bashkia Sarande DKS NJVRN Drejtoria e Personelit dhe Burimeve Njerëzore	2026–2028	Raste të menaxhuara Raste të referuara Mbledhje të MKR Mbledhje të ETN	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” Ligji për shërbimet ekujdesit shoqëror	Pa kosto shtesë	Këshilli Bashkiak DKS
Shërbim edhe mbulim më i mirë i grupeve në nevojë në Njësinë Administrative	Bashkia Sarandë NJVRN Sarandë Koordinator kundër dhunës Sarandë Punonjës social Ksamil	2026-2028	Raportet e vlerësimit të nevojave për çdo njësi.. Ngritja e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NJVNR) Ksamil; numri i rasteve të menaxhuara	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” Ligji për shërbimet ekujdesit shoqëror	3500000 lekë	Bashkia Sarandë; Organizata; Këshilli i Bashkisë
OS 2.2. Digjitalizimi i shërbimeve dhe formim cilësor i profesionistëve dhe referin nderinstitucional						
Bashkëpunim me strukturat për hartimin e hartës digjitale Hedhja e të dhënave në sistem	Bashkia Sarandë NJVRN Sarandë Koordinator kundër dhunës Sarandë Punonjës social Ksamil	2026 - 2028	Numri i shërbimeve Numri i rasteve të menaxhuara	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare	Pa kosto	Bashkia Sarandë; Organizata; Këshilli i Bashkisë

Ofrimi i trajnimeve per punonjësit social dhe të administratorëve shoqërorë në Njesinë administrative	DKS NJVRN Njësia Adm Ksamil	2026 - 2028	Profesioniste të trajnuar Numri i trajnimeve	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare VKM 518	84000 leke ne vit Bashkia Sarande	Bashkia
Krijimi i ambienteve te pershtatshme për intervistim dhe menaxhim rasti	Bashkia Sarande	2026 - 2028	Mjedis i pershtatshem Mjete logjistike kompjuter etj	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare	1,000,000 lekë	Keshilli i Bashkise
Bashkëpunim me institucione drejtoritë e tjera për mbështetje për transport, shoqërim për menaxhimin e rasteve	DKS Policia bashkiake Komisariat Spital Drejtoria ekonomike(mbështetje financiare)	2026 - 2028	Numri i rasteve	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare Marreveshje MKR date 17.12.2024	100000 leke ne vit	Bashkia Sarandw
Bashkepunim me institucionet shëndetësore,qendrat kombetare, qendrat komunitare, ojf-të që japin shërbim për gratë dhe	NJVRN Qendrat kombëtare Qendrat komunitare OJF	2026 - 2028	Numri i rasteve te menaxhuara Numri i sherbimeve Numri i rasteve te referuara	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për masat ndaj dhunës në		Bashkia OJF

vajzat,kryefamiljaret gra dhe viktimat e dhunës				marëdhëniet familjare		
OS 2.3. zgjerimi dhe diversikimi i shërbimeve						
Konsolidimi i Shërbimit në qendren e emergjencës 72 orë për viktimat e dhunës	Komisariati NJVRN Koordianori KDH OJF Qendra komunitare	2026 - 2028	Numri i rasteve Numri i shërbimeve	Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji “Për masat ndaj dhunës në marëdhëniet familjare	Pa kosto	DKS Organizata
Ndihma konkrete materiale si paketa ushqimore, detergjente etj	NJVRN Drejtoria ekonomike	2026 - 2028	Nr i viktimave të ndihmuara Numri i paketave		500000 leke në vit	Bashkia DKS
Këshillim, referim drejt shërbimeve dhe tregjeve të punës për kryefamiljaret gra	NjVRN Koordinator ZVAKPA	2026 - 2028	Numri i rasteve Numri i referimeve		Pa kosto shtese	
Fushata ndërgjegjësuere						

Objektivi strategjik 3. Permirosimi i cilësisë së jetesës për të moshuarit duke përmirësuar shërbimet ekzistuese dhe rritjen e kapaciteteve

<p>OS 3.1 Rritja e kapacitetit të Qendrës Ditore për të Moshuar Sarandë 50 te moshuar do te marrin Shërbimin e kafes Shpenzimet për Qendrën Polivalente te te moshuarve që përballohen nga bashkia . Shtimi i numrit të shërbimeve nëpërmjet punësimit të një infermieri me kohë të pjesshme</p>	<p>Bashkia Sarandë</p>	<p>2026 - 2028</p>	<p>Nr i përfituesve (modeli i qendrës bashkëlidhur) Numri i shërbimeve Për 50 të moshuar shtesë Vetëm shërbim kafe dhe ujë Shërbimi i infermierit</p>	<p>Qendra ditore, Bashkia Sarandë NJVRN</p>	<p>412000 lekë ne vit 1,236,000 lekë për 3 vjet 1 një kujdestar me shumën 570000 leke ne vit</p>	<p>Bashkia Sarandë;</p>
<p>Shtimi i numrit te shërbimeve nëpërmjet punësimit të një psikologu dhe një infermieri me kohë të pjesshme</p>	<p>Bashkia Sarandë QP Drejtoria e Personelit dhe burimeve njerëzore</p>	<p>2027 - 2028</p>	<p>Numri i shërbimeve Shërbim psikologu Shërbimi i infermierit</p>		<p>1 psikolog 1246000 leke ne vit 1 infermier me kohë të pjesshme 635000 leke ne vit</p>	<p>Bashkia Sarandë</p>
<p>OS 3.2 Konsolidimi i shërbimit për të moshuar në Ksamil, pasurimi i aktivitetit të saj.</p>	<p>Bashkia Sarandë Njësia Administrative Ksamil</p>	<p>2027 - 2028</p>	<p>50 te moshuar 30 shërbim ditor dhe 20 shërbim kafe , ujë</p>		<p>29,202,205 17,521,323 fondi Social 11,680,882 Bashkia Sarandë</p>	
<p>OS3.4 Shërbim në shtëpi për moshën e tretë në Sarandë</p>	<p>Bashkia Sarandë NJVRN</p>	<p>2026 - 2028</p>	<p>Nr i përfituesve 70 Numri i shërbimeve</p>	<p>Qendra ditore, Bashkia Sarandë</p>	<p>Organizative/donatore potenciale 2,000,000 ne vit</p>	<p>Bashkia Sarandë; Këshilli</p>

